

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E GJASHTË

VI

**Përktheu: Dr.Musli Verbani
Imam i QIKSHN-së**

Oslo, 2010

HYRJE

Falënderimet i takojnë Allahut, Krijuesit e te gjithë botëve. Përshëndetjet dhe selamet qofshin mbi më të mirin e të gjithë pejgamberëve, vulës se të dërguarve, zotërisë sonë, të Dërguarit tonë, të dashurit tonë, ndërmjetësuesit për ne në ditën e Gjykimit dhe të tubimit - Muhamedit s.a.v.s dhe shokëve te tij në përgjithësi deri në ditën e Gjykimit.

Çdo falënderim dhe çdo përshëndetje shpirtërore për të nderuarin tonë, shejhun tonë, i cili na mahnit me fetva për te cilin nuk do ti kisha mundur të bëj asnjë hap përpara sinqeritetit të tij dhe pastërtia e tij më ka mundësuar të përjetoj këtë libër.

Me nijet të pastër dhe me sinqeritet bashkohen zemrat e besimtareve, dhe idetë e tyre sjellin punë që shpijnë me mirësi, te gjithë kanë nevojë për punë të mira nuk ka çështje më madhështore se të zgjuarit e të pergjumëve me këshilla dhe udhëzime të mira.

Duke u nisur nga kjo pikë, nga shume lexues na kanë arritur pyetje shumë te thjeshta, por ne shejhut tone nuk ia kemi paraqitur, sepse pejgamberi ynë s.a.v.s. është përgjigjur qartë me hadithet e vërteta dhe të sigurta, të fuqishme dhe të cilat përgjigje kanë sjell dobi.

Nga kjo situatë, unë i kam hulumtuar dhe i kam përzgjedhur vetëm këto pyetje pas një analize te thellë. Prej Zotit kërkoj ndihme dhe mbështetje .

Sejid Xhemil
Is Rebiul evel 1402
13.01.1982 KAJRO

USHQIMI I KËSAJ BOTE DHE USHQIMI I XHENETIT

- A është ushqimi i xhenetit i njëjtë me ushqimin e kësaj bote?

- Imami i mirënjohur thotë:

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“E, përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira se ata do të jenë në xhennete në të cilët rrjedhin lumenj. Sa herë që u jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: "Ky është që me te u ushqyem edhe më parë". Ngase, u sillet ushqim i ngjashëm (vetëm në formë, e jo edhe në shije). Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë”.

(El-Bekare, 25)

Deri sa njeriu nuk e di një çështje nuk mund ta emërojë, dhe përderisa nuk e emëron, në gjuhën tonë nuk mund të ketë ndonjë emër tjetër i cili e tregon kuptimin faktik.

Mirëpo Allahu dëshiron të na japë pasqyrë reale, gjendje faktike, për këtë arsye ka sjell shembull, edhe përkundër kësaj ne prapë themi: Kjo është vetëm një pasqyrim, e asgjë reale absolute. Na tregon çështjet të cilat i dëshiron, dhe i kundërshton çështjet tjera. P.sh. Kur na tregon për pirjen e alkoolit në botën tjetër thotë: “Nuk ka në të dehje”, pra e heq prej alkoolit pjesën e dëmshme, e ajo është se alkooli i kësaj bote e turbullon dhe e deh mendjen dhe i epet pjesë tjetër, pra kur thotë Zoti i Lartmadhëruar: “Alkool të ëmbël dhe të shijshëm, për ata që e pinë”.

Zoti i Lartmadhëruar kur t’i tregon llojet e pemëve në xhenet thotë: “... rrush, shegë dhe hurme ...”, pra prej llojeve të cilat gjenden tek ne në këtë botë. Pse? Sepse, nëse na tregon gjëra të cilat nuk gjenden tek ne, vështirë se do t’i pranonte mendja, sepse ato janë gjëra të cilat njeriu nuk i ka njohur më parë, mirëpo kur ta paraqet ty mollën e madhe, formën e bukur, shijen e mrekullueshme, ti veç e ke të njohur mollën dhe erën e saj në këtë botë. Pra, a e pranon apo jo? Për këtë arsye t’i bie shembujt dhe llojet e ushqimeve që ti veç i ke shijuar, i ke përjetuar në këtë botë. Për këtë arsye Kur’ani thotë:

“Çdo herë kur në të furnizohen me ndonjë pemë, perime, lloj ushqimi e furnizimi, thonë: Kjo është ajo me çka kemi qenë të furnizuar më parë (në dunja) dhe furnizohen edhe me gjëra të ngjashme”.

Pse të ngjashme? Sepse është më e kapshme, më e lehtë për ta kuptuar, si dhe çdo gjë e panjohur ndoshta e merr me frikë, me rezervë dhe brengë.

KU ËSHTË DALLIMI NË MES TË “VE MA EDRAKE” DHE “VE MA JUDRIKE”?

- Cili është dallimi në mes të “ve ma edrake” dhe “ve ma judrike”?

- “Ve ma judrike” është mosnjohje për të kaluarën dhe nuk mund të mësohet dhe ta dish as sot dhe as në të ardhmen. Për këtë arsye kanë thënë: “Për çdo gjë çka vjen në Kur’an “Ve ma judrike” nuk mund të dihet, ndërsa për çdo gjë çka vjen në Kur’an “... ve ma zdrake” mësohet dhe dihet”.

Nëse në Kur’an shohim “Ma edrake” do të thotë: nuk e ke ditur në të kaluarën, por nuk ka pengesë për ta ditur sot”, ndërsa kur shohim “Ve ma judrike”, atëherë nuk e di as sot, as në të ardhmen ashtu siç nuk e ke ditur në të kaluarën, pa marrë parasysh se a është hija e errët shumë apo jo e errët.

Për këtë arsye kjo mënyrë nuk ka ardhur për asnjë ndodhi tjetër, por vetëm për çastin e Ditës së Kijametit, dhe për Tezkijen e çështjeve të fshehta. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ve ma judrike (as sot dhe asnjëherë nuk do ta dish) ndoshta dita e Kijametit është afër” natyrisht nuk ka thënë për ngjarjen, sepse ngjarja dihet me siguri se do të ndodhë, por ka thënë për çastin e asaj ngjarjeje: **“Ve ma judrike (dhe ti as sot dhe as në të ardhmen) nuk do t dish se ndoshta Kijameti është afër”.**

Për të dy rastet është çështja e Kijameti se nuk e din dhe nuk do ta dijë, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Ve ma judrike” dhe nuk ka thënë “Ve ma judrake”, sepse mënyra “Ve ma edrake” është për kohën e kaluar, dhe nuk ka pengesë për ta mësuar dhe për ta ditur sot ose në të ardhmen.

Ajeti tjetër “Ve ma judrike” ndoshta pastron. Pastrimi (falja) është vetëm i Allahut dhe askush tjetër nuk mund ta posedojë këtë të drejtë, këtë cilësi. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: Unë nuk e pastroj (fali) për te Allahu askënd”.

Pra, këto tri raste janë përmendur në Kur’an.

Pra tri herë është përmendur “Ve ma judrike”.

Ndërsa 13 herë në Kur’an është përdorur “Ve ma edrake”

Suretul Haka:

Suretul Murselat.

Suretul Infitar.

Kështu mënyra “Ve ma edrake dhe Ve ma judrike” vazhdon të përdoret në suret në vijim. Pra, në suretul Mutaffifinë është përdorur “Ve ma edrake – (çka është sixhini)”, po ashtu në këtë sure “Ve ma edrake – (çka është Ilijun)”. Në suretul-Beled është përdorur “Ve ma edrake mel akabe”; Suretul-Tarik: “Ve ma edrake met-Tarik”; në suretul-Kadr “Ve ma edrake ma lejletul kadr”; në suretul-Kariatu: “Ve ma edrake mel Kariatu”.

SHËRIMI (NDËRMJETËSIMI ME KUR’AN

Shumica e të rinjve pyesin për ndërmjetësimin me Kur'an për qëllime të dunjasë.

Shejh Shaëravi përgjigjet: Ndërmjetësimi me të gjitha format është i ndaluar sepse fjala “Tesevul – ndërmjetësim” është shprehje krijim prej kërkesës, ndërsa kërkesa nuk mund të jetë realizim i qëllimit, por nevojë e paraqitur, pra në moment kur kërkohet meriton të ndihmohet, mirëpo merita e ndihmesës vërehet nga pamja e jashtme, dhe nuk është në rregull pastaj të hulumtohet se ajo kërkesë (lypje) a është vetëm profesion i lypësit, por ndihmohet automatikisht.

Për këtë është rregulla e “rezervës”. Ndihma (dhënia e lëmoshës) është më e vlefshme se sa mosdhënia e ndihmës, se ndoshta me të vërtetë e ka merituar e ti nuk e di se e ka merituar, por ke penguar. Sa i përket ndërmjetësimit (Tesevul) me Kur'an, kjo është dukuri prej të cilët duhet larguar dhe në të njëjtën kohë duhet këshilluar njerëzit të cilët veprojnë një gjë të tillë që të largohen, ashtu që mos ta lejojmë që fjala e Allahut të nënçmohet dhe të nënvlerësohet duke marrë vetëm si mjet kërkueseje e lutjeje.

Mendoj se dukuria e ndërmjetësimit me Kur'an (Tesevul) është si pasojë e zbutjes së zemrave të atyre të cilëve kanë qenë të larguar nga libri i Allahut, me qëllim që t'i afrohen librit të Allahut, dhe të cilët nuk kanë pasur mundësi apo mënyrë tjetër që atyre t'u zbuten zemrat. Ndërsa praktika islame na obligon që mënyra e shërimit të kësaj çështjeje (zbutjen e zemrave) të jetë në atë mënyrë duke u krijuar atyre ngrohtësi për t'i tejkaluar problemet e tyre dhe për t'i zgjedhë çështjet e tyre, e jo për t'ua dhënë atyre librin e Allahut, e ata ta keqpërdorin dhe ta ultësojnë.

DALLIMI I DISA SUREVE DHE AJETEVE PREJ DISA SUREVE DHE AJETEVE TJERA NË KUR'AN

Pyetje: A ka në Kur'an ajet i cili është më i vlefshëm se ajetet tjera, dhe sure e cila është më e vlefshme se suret tjera?

Përgjigjja: Nuk thuhet ajetet më të vlefshme se ajetet tjera, sepse çdo ajet është fjalë e Zotit, mirëpo secili ajet në vendin e vet është dobi. P.sh. nuk thuhet për barin (ilaçin) i përbërë prej bimëve të shumënumërta dhe elementeve të ndryshme kimike të shumta, se ky element është më i mirë se ky element, sepse secili element në vetvete kryen detyrën e tij e cila është e dobishme dhe ndihmon shërimit dhe shëndetit.

Mirëpo, ajetet e Kur'anit në raste të veçanta kryejnë detyra të veçanta në Kur'anin i cili përbëhet prej ajeteve secili ajet e ka vlerën se ai ajet aty shëron plagën, pra ai ajet me fashën (lidhjen e tij) është dobi dhe ne nuk themi se ky ajet është më i mirë se ajeti tjetër, për arsye se ajeti tjetër ka hapësirë tjetër ku sjellë dobi.

A I FSHINË PENDIMI MËKATET?

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Allahu nuk i dënon ata derisa ti je në mesin e tyre, Allahu nuk i dënon derisa ata kërkojnë falje”.

A do të thotë kjo se Istigfari i fshinë gabimet?

Përgjigjja - Shjejh Shaëraviju përgjigjet: Ky ajet fisnik na sqaron kuptimin e Istigfarit. Po si të mos ndodhë kjo kur në zemrën e njeriut ka besim. Kuptimi i ajeti është se Allahu nuk i dënon ata derisa të jesh në mesin e tyre, sepse Unë ty të kam dërguar mëshirë për botët, dhe mëshira Ime i paraprinë dënimin. Për këtë arsye Unë nuk dënoj ata duke qenë ti në mesin e tyre i mëshirshëm dhe udhëzues. Pastaj, ajeti fisnik vazhdon të sqarojë se çka do të ndodhë pasi që i

Dërguari të kalojë në botën tjetër dhe këtu përfundon teksti: “Allahu nuk i dënon ata derisa ata pendohen”. Pra, kur ti o Muhamed kalon në praninë Time, atëherë Unë nuk do t’i përshij me dënim pendimtarët. Pse? Sepse pendimi është nënshtrim ndaj Allahut dhe nuk ka nënshtrim vetëm se në zemrën e besimtarit dhe derisa Imani zë vend në zemrën e besimtarit, atëherë mëshira e Allahut është mbi të.

Kështu Zoti i Lartmadhëruar na tregon vlerën e pendimit tek Ai, e si nuk ndëshkon, e i fshinë gabimet, e çfarë vlere ka pendimi te Ai. Allahu thotë:

“Dhe nëse ata i bëjnë padrejtësi vetes së tyre, e vijnë te ti, e pendohen te Allahu, e kërkojnë falje, e ata i falë i dërguari, do të shohin se me të vërtetë Allahu është Pendimpranues dhe i mëshirshëm”.

Pra, faza e parë e faljes së mëkatit dhe më e rëndësishmja është pendimi. Nënshtrimi ndaj Allahut dhe përkushtimi ndaj Tij janë prej shenjave më të fuqishme të pranimit të pendimit. Zemra e jobesimtarit nuk ka mëshirë, nuk ka falje. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. vazhdimisht e ftonte umetin e tij për të kërkuar falje. Në një rast ka thënë:

“Pendohuni te Allahu, se vërtet unë kërkoj falje prej Tij njëqind herë në ditë”.

Përderisa të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. i janë falur gabimet e mëhershme e më të vonshme dhe ai është penduar njëqind herë në ditë, po si është puna me ne atëherë?!

Pra, pendimi është shkallë prej shkallëve të Imanit dhe nënshtrimit ndaj Allahut të Lartmadhëruar, dhe nuk hyn pos në zemrën e besimtarit, dhe nuk flet sinqerisht pos njeriu i cili i frikohet vetëm Allahut, dhe nuk nxiton në pendim, pos ai i cili i frikohet Zotit të Tij, dhe i frikohet Ditës së Gjykimit. E ndoshta Allahut pranon lutjen, falë gabimin dhe zbret mëshirën e Tij.

Përderisa Allahu i Lartmadhëruar urdhëron të Dërguarin e Tij fisnik për kërkim falje, nëpërmjet tij Ai na ka urdhëruar që të gjithë ne, dhe përderisa Allahu i Lartmadhëruar ka urdhërua të Dërguarin për Istigfar, të cilit ia ka falur gabimet e mëhershme dhe të mëvonshmet. Kjo është një çështje e cila kërkon vazhdimisht prej nesh të kërkojmë falje.

Pendimi dhe falja e gabimeve prej Allahut i fshinë gabimet tona e kush mund t’i falë gabimet pos Allahut. të gjithë duhet së bashku dhe vazhdimisht të kërkojmë falje, të hiqet e padrejta, të pendohemi tek Allahu dhe të zbuten zemrat tona. Pra Istigfari gjithmonë na përkujton fuqinë e Allahut dhe mundësinë e Tij, ndërsa dobësinë e robit dhe paaftësinë e Tij. Dhe gjithmonë kur të harrojmë kjo na bën që ta kujtojmë Allahun. Gjithmonë kur kjo botë na tërheq në vete dhe na largon prej urdhrave të Allahut, llogarisë para Tij, na bën që t’i nënshtrohemi fuqisë së tij të madhe dhe mundësisë së Tij të pakufishme, të Cilin e adhurojmë, e Ai është Allahu i Lartmadhëruar.

Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë të Dërguarit të Tij:

“Dhe kërko falje për gabimin tënd”

Pyetje: Cilin gabim e ka bërë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për të cilin ka qenë dashtë të kërkojë falje?

Përgjigjja: Duhet t’i kemi parasysh dy çështje:

E para: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. është dërguar mëshirë për të gjithë botët e nga këtu manifestohet mëshira dhe se Allahu i Lartmadhëruar është i fuqishëm, i cili jep rast e ju me i dhënë rast atij. Nëse Ai dënon Ai dënon se është i fuqishëm dhe ka mundësi ta bëjë këtë.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ngarkonte veten me jobesimtarët dhe hipokritët më shumë se sa kishte mundësi, e rëndonte dhe e mundonte veten e tij për ta, për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar në Kur’an i thotë:

“Ne nuk ta kemi zbritur Kur’anin për të të rënduar”.

E Muhamedi a.s. ka pranuar arsyetimin e munafikëve, pse janë zbrapsur nga fronti, e Zoti i Lartmadhëruar i thotë:

“Zoti ta fali ty pse u ke dhënë leje (që të mos shkojnë në front)”.

Këtu Zot i Lartmadhëruar e kritikon të Dërguarin e Tij pse i ka tejkuluar normat e mëshirës, pse ato janë jobesimtarët të cilët e kanë maltretuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe e kanë luftuar fenë e Allahut, e kur kanë vdekur Muhamedi s.a.v.s. ua falë atyre dhe lutet për mëshirë për ta.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe mos ua fal namazin e ndonjërit prej tyre asnjëherë”.

Pyetje: Po namazi i të Dërguarin të Allahut s.a.v.s. është mëkat?

Përgjigjja: Është tejkalim i normave të mëshirës dhe angazhimi i të Dërguarit të Allahut duke kërkuar mëshirë për ta, e Zoti i Lartmadhëruar i drejtohet atij:

“Nëse kërkon falje për ta edhe shtatëdhjetë herë, Allahu kurrë nuk ua falë atyre”.

SËMUNDJET E ZEMRËS DHE SHËRIMI I TYRE

- Kur’ani fisnik në shumë vende tregon për sëmundjet e zemrës, si p.sh. ajeti:

“Në zemrat e tyre ka sëmundje, dhe për këtë Allahu ua shton edhe më shumë sëmundjen”.

Çka ka për qëllim ajeti “sëmundjet e zemrës” dhe a janë sëmundje konkrete (fizike) apo sëmundje psikike e shpirtërore (kuptimore)?

- Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Sëmundje është kalimi i trupit prej baraspeshës, prej binarëve. ti nuk mund ta ndiesh dhembjen në sy kur të lëndohet syri deri atëherë kur kalon prej kufirit të baraspeshës. Nuk mund ta ndiesh sëmundjen e barkut derisa të të dhemb, nuk mund ta ndiesh sëmundjen e veshkës derisa të dhemb. Nuk të dhemb asnjë pjesë e trupit derisa të del prej vendit të tyre.

Kalimi i trupit prej vendit normal të tij tregon sëmundjen, e shenja e kalimit të trupit prej vendit normal të tij është dhembja. Kjo dhembje është tregues i lëkundjes së shëndetit, sepse është tregues i sëmundjes, sëmundjet të cilat vijnë dhe gjenden në trup, pa dhimbje janë më të vështira për shërim dhe më të rrezikshme.

Pastaj vazhdon Imami i mirënjohur:

Sa i përket zemrës ajo është pjesë fizike (konkrete) e stërmbushur me gjak, ajo jep lëvizje dhe jetë. Kjo është ana materiale, ndërsa në çështje abstrakte, çështjet logjike përqendrohen dhe depërtojnë në zemër dhe e komplikojnë, e shtrëngojnë, dhe nuk mund të lirohet më nga ai shtrëngim. Lëvizja e trupit, pra e jetës bëhet nëpërmjet këtyre çështjeve. Hapësirën të cilën e përfshinë zemra quhet mendje (zemër + mendje). Zemra dhe mendja.

Pra, zemra (kalb) dhe mendja (fund) janë në kraharor, gjoks. Allahu kur tregon për zemrën tregon me metodologji dhe forma të ndryshme, kur thotë:

“Dhe zemra (Fuad-gjoksi, kraharori) i nënës së Musait u bë e zbrazët”.

Pra, nuk e ka përdorur fjalën “kalb-zemër”, por e ka përdorur fjalën “Fuad – gjoks, mendje”. Sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe sikur mos ta kishim ndërlidhur dhe përforcuar zemrën e saj (kalbeha)”

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“A nuk ta kemi zgjeruar ty kraharorin tënd”. Pra, zgjerimi i zemrës në tërësi, e jo vetëm zgjerimi i mendjes ose vetëm zgjerimi i zemrës.

Pra, ajeti fisnik, i cili përmend sëmundjen e zemrës ka për qëllim sëmundje kuptimore-abstrakte, e kjo do të thotë të kaluarit jashtë normales.

Cili është kufiri hapësinor normal i zemrës? Kufiri i normales është që të jetë në atë masë, pra besimi i cili të afrohet të jetë i përmbushur në njërin anë, dhe në anën tjetër të gjitha çështje

tjera, pra balancimi dhe ekuilibrimi në mes tyre, e pastaj cila prej dy çështjeve të qetëson e vendosë në zemër.

Ndërsa njëra çështje të mbetet në zemër, e të diskutohet çështja tjetër, kjo nuk është drejtësi e pranimit të ofertës, ose kjo mund të quhet anim i shërimit të zemrës. Por balancim i plotë është të dalit e të dy çështjeve nga zemra jote e pastaj t'i analizosh, e më në fund cila të jetë më prioritare ta vendosësh në zemër. Ky është balancimi dhe ekuilibrimi më i drejti dhe më i sakti. Sepse Allahu asnjë njeri nuk e ka bërë me dy zemra në gjoksin e tij që me dy zemra t'i analizojë dy çështje, por t'i analizojë vetëm me një zemër, në një hapësirë. Ndërsa në një hapësirë nuk mund të vendosen dy hapësira të ndryshme asnjëherë.

Nëse ti një çështje e ke në zemër, e pastaj ti e analizon çështjen tjetër, tjetra asnjëherë nuk hyn në zemër.

Imami na sjell një shembull:

Shiko në gjërat e kapshme, shiko në gotën e zbrazët, e pastaj mbush me ujë e sheh se uji nuk mund të depërtojë pa e larguar ajrin nga ajo gotë. Pra ajri del duke u mbushur gota me ujë. Nëse ti këtë e vendos në zemrën tënde duke e analizuar çështjen, ti je larguar nga natyrshmëria. Nëse ti e largon nga zemra natyrshmërinë, atëherë sëmundja jote vetëm se vjen e shtohet.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Në zemra të tyre ka sëmundje e ua shtoi atyre Allahu sëmundjen edhe më shumë”.

CILIN LLOJ TË XHINËVE MUND TA NËNSHTROJË NJERIU?

Ne e dimë se xhinët janë shumë llojesh, një lloj janë të mirë ,e një lloj janë pabesimtarë të këqij të cilët shkaktojnë dëme.

Pra cilin lloj i xhinëve mund ta nënshtroj njeriu llojin e të mirëve apo llojin e të këqijve?

-Imami i nderuar përgjigjet: Xhinët të cilët mund ti nënshtroj njeriu mundet me qenë dy llojeve:: llojit të xhinëve të mirë dhe llojit të xhinëve të të këqijve. Xhini i mirë është sikurse njeriu i mirë, askush nuk mund ta nënshtroj ,me fjalë tjera nuk i nënshtrohet askujt. Atëherë nënshtrohet lloji i xhinëve të këqij ,dhe kjo vetëm çka sjell vështirësi me xhinët e tij.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

„Dhe me vërtet kanë qenë burra prej njerëzve të cilët harronin mbrojtje dhe mbështetje prej xhinëve për këtë arsye ne iu shtuam atyre edhe më shumë vuajtje-*Rebeka*.

I shtuam vuajtje (rebeka)-pra iu kanë shtruar vuajtjet vështirësitë dhe problemet sepse ata janë tregu mendjemdhenj, kryelartë dhe kanë kundërshtuar me vepruar me drejtësi, pra me ligjin e njeriut.

Iu thotë atyre: Neve na është dhënë ligj i cili është më i mirë se i yti.

Në këtë rast nuk thuhet se: veprat shpërblehen sipas qëllimit, sepse qëllimi yt dëshiron që të realizohet tek njeriu me ligjin i cili nuk është ligj i njeriut.

Imami i mirënjohur e sqaron një çështje shumë të rëndësishme kur thotë:

Çdo gjë çka shohim prej dukurive të çuditshme (fantazma) prej veprimeve të shpirtave të këqinj t'q gjitha ato dukuri, veprime ,fshehtësi mundet që njeriu të nënshtrohet tjetrit, dhe të veproj atë çka njeriu tjetër nuk mund të veproj, por edhe xhini i rëndomtë (i mirë) nuk mund ta bëjë atë veprim.

Pyetje: Por a mundet që njeriu të nënshtroj shpirta të këqij të cilët mund të shpejtojnë diçka njeriut në jetë ose t'i vonojnë ose mos me i ndodh

Përgjigje: Jo, kurrsesi. Për shkak se shohim ata të cilët merren me këso veprimtari që të gjithë janë të goditur me shumë gjëra, dhe janë të lodhur me shumë gjëra. Pra ,aty ka krijesa të fshehta nga shikimi ynë ,dhe ata kanë ligje tjera dhe e vërteta është se xhinin e kategorisë më të vogël mund ta nënshtroj xhini i kategorisë më të madhe.

DITËT E ALLAHUT

Zoti i Lartmadhëruar thotë:Në ditën ku gjatësia e asaj dite është njëmijë vjet,të viteve të cilat i llogaritni dhe numëroni ju

A është dita e llogarisë së Allahut sikurse e ditës tek njerëzit. Pra dita te njerëzit është 24 orë ndërsa tek Allahu a është e njëjta llogari apo jo?

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar thotë:

Ai i cili ka krijuar qiejt dhe tokën për 6 ditë, pastaj ka përfshi dhe ka nënshtruar arshin. Cila është gjatësia e këtyre 6 ditëve në llogarinë e krijesave dhe llogari te Krijuesit të Lartmadhëruar. Imami i mirënjohur thotë:

Ka dallim në mes të asaj kur them se unë e kam prodhuar këtë pako për 6 orë, dhe në mes të asaj se ti ke ardhur me elementet e qumështit, thartësirës dhe i ke vendosur për një çast vetëm ke thënë bëhu dhe ajo bëhet. Pra, nuk na ka krijuar për nëntë muaj por na ka krijuar me fjalën „bëhu" dhe është bë. Dhe sikurse Allahu ka thënë: E ka krijuar për gjashtë ditë,nuk ka të bëjë me gjashtë ditë. Koha është në tërësi pjesë e ndodhisë ,dhe se kuptimi me qenë kohë e ndodhisë është se çdo pjesë e ndodhisë përputhet me pjesën e kohës. Kjo është recepta. Mirëpo Allahu punon pa recepturë. Allahu e punon me “bëhu”, mbase elementet e qiellit apo të tokës Allahu është ai i cili ka vendosë fshehtësitë dhe sekretet të cilat reflektohen atëherë kur Ai dëshiron e pastaj e len të reflektohen. Zoti i Lartmadhëruar thotë:Çdo ditë brenda 12 orëve. Tjetrën ditë? Ai është aktiv gjithmonë. Pra në çdo çast. Për këtë arsye kur i kanë pyetur dijetarët Ai(Allahu)për çdo ditë është në aktivitet. Çfarë aktiviteti kryen Zoti ynë, pasi që është e vërtetë se ngjyra e lapsave është terur. Çdo gjë ka marrë fund. Janë përgjigjur: Çështjet të cilat janë krijuar e që vendosen në aksion. Ka dallim të madh në mes të krijimit dhe fillimit të sendit të krijuar. Fillimi i sendit është krijimi i atij sendi, ndërsa fillimi i sendit të krijuar është paraqitja e atij sendi në skenë. Pasi astronomia është zhvilluar deri në atë shkallë ne e kemi kuptuar se Gjithësinë, sistemin diellor, e kemi kuptuar sistemin diellor dhe sistemet tjera afër tij etj etj. E kemi kuptuar se fjala ditë është çdo çast. Pastaj parashtrohet pyetja:Pse?Sepse nëse në bazë të definimit tuaj ditë quhet hapësira kohore prej lindjes së diellit e deri në perëndimin e tij dielli gjithmonë,në çdo qastë lind e perëndon. Kjo do të thotë se „kut thotë për çdo çast":Për çdo ditë është në aktivitet. Ka për qëllim çdo çast. Kuptohet se në çdo çast është në aktivitet. Pse?Sepse nëse supozojmë se kjo ditë fillon në orën pesë të mëngjesit e deri në orën pesë të mbrëmjes në orën pesë e një minutë fillon dita tjetër dhe përfundon në pesë e një minutë. Po ashtu edhe minutat i kanë pjesët përbërëse, sekondat e kështu me radhë. Pra fjala ditë është në çdo çast. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: Në çdo ditë (qastë) është në aktivitet. Kjo do të thotë ai vazhdimisht e pandërprerë është në aktivitet ku përmendet Ezani, Allahu dhe sekondat e jetës nuk përfundojnë .Çdo fjalë që dëgjohet nuk përfundon dhe çdo kryerje e adhurimit nuk përfundon. Kjo do të thotë kur Muedhini (Thirrësi për namaz) thotë:Allahu Ekber" për namazin e sabahutnë vendin tjetër është Muedhini tjetër i cili thotë„Allahu Ekber" ndërsa tjertri “Eshhedu en la ilahe illallah" e Muedhini tjetër thotë: Eshhedu ene Muhamedun Resulullah". Pra fjala e ezanit dhe ibadetit janë të ndërlidhura gjithmonë dhe nuk përfundojnë. Allahu vazhdimisht thirret me “Allahu Ekber"Allahu Ekber. Në çdo çast prej çasteve të ditës dhe në çdo çast prej çasteve të natës, dhe në çdo ibadet prej ibadeteve i bëhet lutje Allahut. Përderisa këtu falet sabahu në një vend tjetër falet dreka, e një vend tjetër ikindija, në një vend tjetër falet akshami e në një vend tjetër jacia. Nga kjo edhe mund të komentohet thënia kurioze e atyre të cilët thonë: Oj kohë ,dhe në ty janë të gjitha kohërat. Pra thënia e Zotit të Lartmadhëruar: “Sundimtarit të ditës së gjykimit"A nuk është ai sundimtar ,udhëheqësi çdo çështje po ashtu të jashtë ditës së gjykimit. Mirëpo pasi që për sundimtarin dhe për sundimin ka çështje të cilat manifestohen në gjithësi e kjo do të thotë se:Kur ne shohim një personalitete quajmë sundimtar,e kur shohim tjetrin e quajmë sundimtarë simbolikisht. Pra çështjet pasi që janë të dukshme dhe të padukshme. Disa njerëz janë sundimtarë në aspekt formal (jo real)Ndërsa në

botën tjetër nuk do të ketë as sundim formal, por që të gjitha çështjet në tërësi do të jenë të Allahut. Kjo është arsyeja pse te njeriu paraqiten shkaqet pra këtu jetojmë me shkaqet e Allahut. Këtu fjala „dita e kijametit“ (dinë-kijamet) ka kuptimtë shumëfishtë. Këto kuptime dijetarët ku i kanë sqaruar i kanë sqaruar kështu: Dinë-ka kuptim shpërblimin .Shpërblimin për çka?

Për nënshtrim. Nënshtrim për çka? Ndaj urdhrit të Allahut. Çka është ajo që tregon nënshtrim ndaj urdhrit të Allahut. Planprogrami dhe sheriati.

Pra shpërblimin për nënshtrim, nënshtrimin në çka, nënshtrimin të planprogramit të Allahut. Pra këtu i kemi tri elemente. Shpërblim nënshtrim dhe planprogram.

Pyetja: Pse ka thënë : Sundimtar i ditës së shpërblimit e nuk ka thënë „ditës së kijametit“?

Përgjigje: Sepse dita e kijametit është skenë prej skenave të ditës së kijametit. Kijamet pra do të thotë do të ngriten njerëzit nga varret e tyre. Mirëpo përderisa ka tubim llogaridhënie, kalim në urë të siratit dhe shpërblim, ndërsa shpërblimi është akti i fundit e ka tregu aktin e fundit. Sepse parashtrohet pyetja? Pse ringjallemi? Ringjallemi që të shpërblehemi, pra shpërblim është finalizimi. Ai i cili thotë: Dita e shpërblimit apo dita e shpagimit ai ka për qëllim ditën e kijametit. Sepse shpërblim është finalizimi i adhurimit në përgjithësi. Varësisht prej asaj si ka qenë adhurimi ynë , ashtu do të jetë edhe shpërblimi ynë. Për këtë arsye shohim se Kur'ani kur e shtjellon këtë çështje thotë: Dhe ai i cili shpreson në takimin me Zotin e tij le të punojë punë të mira, dhe me adhurimin e Zotit të tij, mos t'ia shoqëroj askënd tjetër"

Për këtë arsyen kur ta paraqesim para njerëzve fjalën fe kemi për qëllim paraqitjen e shariatit. Themi: Ndjenjë, pasion dhe vërtetësi. Pse feja ndikon në personalitet. Që do të thotë: nëse ti kë një shumë të pasurisë , dhe sheh se ndonjë njeri ka nevojë, menjëherë ndikon në qenien tënde. dhe të mundon. E vërteta është se ti e dëshiron fitimin. Por kush e kupton dhe kush e di çka është fitimi? E kuptojnë vetëm njerëzit që kanë pasione. Pra , Ai i cili dëshiron takimin me Zotin e tij le të veprojë punë të mira dhe mos t'i bëj idhujtari në adhurimin e tij askujt tjetër pos Tij.

E adhuron vetëm Atë, e falënderon vetëm Atë. Pra falënderimi vetëm për Zotin e gjithë botëve falënderimi vetëm për të Gjithëmëshirshmin, falënderimi vetëm për sunduesin e ditës së gjykimit.

PO TË MOS KISHIM PËRFORCUAR TY

Kanë diskutuar shumë prej analistëve për madhësinë.

Muhamedin kur ata e kanë lexuar ajetin kur'anor:

„Po të mos kishim përforcuar ne ty“

Ata thanë se kjo është nënçmim për të Dërguarin prej Zotit të Lartmadhëruar, sepse sipas tyre ka anuar në krahun e pabesimtarëve, e për këtë arsye ka zbritur ky ajet. Çka mendon Sheh Shaëraviju në lidhje me këtë:

Imami i nderuar mendon se:

Çështje se i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka anuar në krahun e pabesimtarëve , dhe se ajeti “Po të mos kishim forcuar ty” është nënçmim për të Dërguarin, lirisht mund të themi se: I Dërguari i Allahut s.a.v.s nuk ka anuar asnjëherë në krah të pabesimtarëve, sepse nuk kishte filluar zbritja e ajetit “po mos”?. Sepse Allahu i Lartmadhëruar nuk ka lejuar që të ndodhë një gjë e tillë. Pastaj Zoti i Lartmadhëruar na tregon se *po në at mos duhet ose bëhet* afrimi tek Allahu, dhe zbulimit të ajeteve, shenjave dhe argumenteve prej tij nga robërit e tij nëse robërit mohojnë pas kësaj, atëherë dënimi i tyre do të jetë i dyfishtë në krahasim me njerëzit tjerë, apo siq e ka thënë Allahu Isa a.s. për Havarijunët “Dhe kush mohon prej juve pas kësaj, atëherë unë do ta dënoj me dënim të madh, që me aso dënim nuk do ta dënoj askënd prej botëve.

TEORIJA E DARVINIT DHE SHARAVIJUT

Si është çështja e teorisë së Darvinit dhe shkencëtarëve tjerë të cilët e kanë pranuar një teori të tillë një kohë dhe a është e vërtetë shkencore apo vetëm teori?

Imami i mirënjohur Shaëraviju përgjigjet: Ajo është vetëm teori mirëpo, ata të cilët nuk kanë kuptuar e kanë marrë si të vërtetë shkencore e nga këtu ka buruar gabimi.

Ata të parët të cilët e kanë pasuar Darwinin për të parën herë, ata e kanë demantuar herën e dytë. Atëherë pse e lodhim veten tonë në këtë çështje aq sa nuk duhet për tu lodhur. Ne atë çka e ka thënë Darvini e vendosim në një dorë dhe atë çka ka thënë Allahu në dorën tjetër!?

Mjafton vetëm ky krahasim për me qenë të humbur. Po atë i cili është sprovuar më këtë teori mund ti përgjigjemi thjeshtë: Cilët faktor kanë qenë që majmuni i parë me u shndërruar në njeri?

Pse majmunët tjerë nuk janë shndërruar në njeri por kanë mbetur majmunë: Pse nuk kemi vërejtur *apo* nuk kemi pa se majmunët e tjerë nuk iu kanë nënshtruar këtij procesi që të zhvillohen e të bëhen njerëz. Nëse ne e kemi prejardhjen prej majmunit, por majmuni nga çka e ka? E ai çka, prej çka-it.

Pra patjetër duhet me qenë diçka prej diçkaje dhe do të arrijmë te çështja e parë, prapë prej çka-it. Llojet tjera të gjallesave a kanë edhe ato prejardhje, që të kenë një origjinë. Bimët të cilat gjithashtu edhe ato kanë shenja të zhvillimit më të ulët, a kanë edhe ato prejardhje, ashtu që duke shkuar nëpërmjet prejardhjes zinxhimore të tyre me arritur në një origjinë e cila është zhvillu. Nëse puna është kështu atëherë pse nuk po shohim ndonjë zinxhir prej zinxhirëve të kafshëve ose zinxhir prej zinxhirëve të bimëve duke u zhvillu para syve tanë në diçka tjetër.

Në të kaluarën është thënë kjo pa u kuptuar se bima e fundit është kafsha e parë. Kjo është vetëm ndjenjë dhe paramendim se bima mbetet bimë siç ka mbetur dhe kafsha kafshë.

Kështu edhe kafshët ndoshta mund të zhvillohen në një organ apo disa organe dhe marr ndonjë veçori të njeriut, por kjo është aftësia e të imituarit, mirëpo prapëseprapë, mbetet kafshë dhe nuk mund të zhvillohet në njeri.

Shembull për këtë kemi: Nëse e mësojmë majmunin çfarëdo veprimi ai mund ta veproj një gjë të tillë, mirëpo atë veprim ai nuk mund t'ia mësojë llojit të tij, por prapëseprapë mbetet majmun ashtu siq është.

të mbeturit e krijesave në formën e tyre siq janë të krijuara është argument se ato nuk evulohen por janë të paevoluara

DOMOSDOSHMERIA E BARAZISË NË MES FËMIJËVE

Prindi i tri vajzave nuk ka djalë për me i taku pjesa e trashëgimisë ai ka pagë prej së cilës pagë deponon në Bankën Islame p.sh. në Bankën Fejsul për me iu shpërnda vajzave në mënyrë proporcionale .A është e lejuar kjo me sheriatin Islam?

Përgjigje: Prindi ka të drejtë dhe liri që ti dhuroj gjatë jetës së tij sa të donë. Për këtë çështje janë pajtuar të gjithë derisa ndarja bëhet në mënyrë proporcionale dhe nuk është haram .Ajo çka është haram është atëherë kur dallohet njëri fëmijë prej tjetrit ose njëri fëmijë prej tjerëve. Niemam bin Beshirë ka shkuar te i Dërguari i Allahut s.a.v.s dhe i ka thënë: O i Dërguari i Allahut i kam dhënë djemve të Nuëmaniut kaq e kaq. Muhamedi a.s. i ka thënë: A ju ke dhënë fëmijëve njësoj sa i ke dhënë Nëumanit? AI i thotë: Jo Muhamedi a.s. i thotë: Le të dëshmon për këtë ndokush tjetër sepse unë nuk dëshmoj për padrejtësi.

Sa i përket shumës së caktuar për dhuratë vajzave ,le të jetë sa i nevojitet për përgatitjen e tyre për martesë. E jo tërë pasurin të cilën e posedon ose e deponon sepse kjo do të thotë zvogëlim i trashëgimisë pas vdekjes së prindit.

MËNYRA E HAXHIT

Cilat janë mënyrat e kryerjes së haxhit dhe Umres

Përgjigje: Haxhi ka tri mënyra

E para: Haxhi tek (*IFRAD*):Pra haxhi kur bëhet nijeti vetëm për kryerjen e haxhit dhe pasi që të kryhet në tërësi dhe lirohet në tërësi prej të gjitha ndalesave. Bën nijet dhe vesh ihramin për umre dhe nuk e ka për detyrë(vaxhib) të presë kurban (*Hedj*)

E dyta: Haxhi i bashkangjitur me umren(KIRAN):Është Haxhi kur nijeti bëhet për kryerjen e haxhit dhe umren me një ihram të përbashkët dhe më një rruarje apo shkurtim të flokëve të përbashkët dhe e ka për detyrë(vaxhib) me pre kurban kur të lirohet prej ihrami.

E treta:Haxhi (*Temetuë*): Është haxhi kur vishet ihrami për të parën herë vetëm për umre dhe pasi ta përfundon dhe të lirohet prej ihramit,e bën nijetin dhe vesh ihramin për haxh në ditën e 8 të muajit Hixhe.Dhe e ka për detyrë(vaxhib)me pre kurban pasi të lirohet prej ihramit të haxhit

SADAKAJA E GRUAS PA LEJEN E BURRIT TË SAJ

Pyetje: Sadakaja prej pasurisë së gruas pa leje e burrit a është haram apo hallall?

Përgjigje: Një grua e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s për stolin e saj të cilën e ka dhënë sadaka. Ndërsa Muhamedi a.s. i ka thënë “Nuk lejohet që gruaja të jep diçka prej pasurisë së saj pa lejen e burrit të saj

Në një transmetim tjetër:Nuk lejohet për gruan asgjë prej pasurisë së saj ,pasi që burri i saj e ka në bashkëshortësi dhe e ka në përgjegjësi atë dhe pasurinë e saj.

E kanë transmetuar *Ehlu-Suneni*

Ibn Maxhe transmeton se gruaja e Keab ibn Malikut ka shkuar te Muhamedi a.s dhe i ka thënë:E kam dhënë sadaka këtë stoli. Ndërsa Muhamedi a.s i ka thënë:Nuk lejohet për gruan asgjë prej pasurisë së saj nëse nuk merr leje prej burrit të saj,dhe a ke marrë leje prej Keabit për këtë:Ajo iu është përgjigjur: Po. Muhamedi a.s e ka dërguar një *sehabe* te Keabi dhe e ka pyet: A i ke dhënë leje *Hirjetës* (gruas tënde) për me dhënë sadaka stolinë të saj. Ai është përgjigj: Po. Atëherë Muhamedi a.s e ka pranuar sadakanë e saj.

MËKATET E VOGLA DHE MËKATET E MËDHA

Kur Allahu i falë mëkatet e të gjithëve ,në përgjithësi a do të thotë se falen edhe mëkatet e mëdha apo vetëm mëkatet e vogla?

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:Thuaj: O robërit e mi, të cilët ju jeni ata të cilët e keni tepruar në mëkate në dëm të vetvetes suaj, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Vërtet Allahu falë gabimet për të gjithë së bashku në përgjithësi". Kjo ka a ka të bëjë me mëkatet e mëdha si p.sh. idhujtarin ose prostitucionin

Shejh Shaëraviju thotë:

“Në ajetin Kur'anor ***‘Vërtet Allahu falë gabimet për të gjithë së bashku në përgjithësi’*** nuk përfshihet idhujtaria sepse idhujtaria nuk është mëkat. Për arsye se mëkat quhet ti me vepruar diçka që rregull është në besimin tënd, nëse e vepron dënohesh. Ndërsa sa i përket idhujtarisë ,idhujtaria është tradhtia e madhe. Argument për këtë është ajeti tjetër: “Vërtet Allahu nuk falë kur të i bëhet idhujtari dhe i bëhet ortak atij,përpos kësaj i falë kujt të donë”

Idhujtarinë nuk e quajmë mëkat ,pse është më e madhe se sa mëkati. Sepse mëkati është që ta pranosh planprogramin pra besimin,mirëpo e ke kundërshtuar këtë program kur të është thënë :Veproni këtë dhe këtë,pra mosveprimi i kësaj apo asaj është mëkat,mirëpo është në pyetje kur njeriu nuk e beson planprogramin në tërësi. Pra mosbesimi i planprogramit në tërësi nuk bën pjesë në brendi të mëkateve, për këtë arsye të gjithë komentuesit kur ta interpretojnë pjesën e ajetit,,Vërtet Allahu i falë të gjitha gabimet në tërësi për të gjithë juve përpos idhujtarinë,duke e

përfshi idhujtarinë në listën e mëkateve,,pse,,vërtetë Allahu nuk falë ,nëse i bëhet idhujtari Atij dhe i fal përpos kësaj atij që dëshiron Ai. Falja e mëkatit Zoti i Lartmadhëruar e ka rendin ,vetëm me dëshirën e Tij,apo vetëm është renditje në ajet?Është thënë se “Vërtet Allahu fal gabimet në përgjithësi .Mirëpo çka ka thënë Zoti i Lartmadhëruar në ajetin tjetër: Dhe kthehuni te Zoti juaj dhe dorëzohuni Atij" pra mos me menduar se ju falen gabimet në tërësi nëse nuk bëhet dorëzimi dhe kthimi te Ai: Zoti i Lartmadhëruar veç ka thënë

EZ-ZUMER 54-56

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Vërtet Allahu i falë mëkatet, gabimet e të gjithëve,mirëpo pas kësaj thotë: Kthehuni te Zoti juaj nëse kthimi do të thotë pendim, atëherë pendimi nevojitet para kthimit, nëse nuk pendohet dhe nuk kthehet atëherë Allahu nuk i fal atij, sepse ka thënë:,,Dhe kthehuni te Zoti juaj". Njeriu pra nuk duhet ta merr vetëm pjesën e jashtme të ajetit,pse ajeti fillon”. O ju robër te Allahu të cilët e keni tepruar, i keni tejkaluar kufijtë, pra nuk tregon ajeti ,nëse mëkat është çështje të cilës nuk mund ti iket në tërësi,mirëpo pendimi ta shlyen mëkatin të mirat e shndërrojnë të keqen në të mirë. Ndërsa deri sa njeriu i tejkalon kufijtë e mëkateve, dhe pas kësaj nuk pendohet, dhe nuk bën dëm të mira për me i shndërruar të këqijat në të mira dhe angazhohet dhe nuk kthehet në besimin e Allahut" Kjo nuk lejohet në Islam.

KU ME TË KËRKU NË DITËN E KJAMETIT

Pyetje: Është e vërtetë se Muhamedi s.a.v.s ka me ndërmjetësuar umetin e tij në ditën e kijametit, kjo është specifikë prej specifikave të Muhamedit a.s me të cilën e ka dalluar prej të gjithë peygamberëve, Cilat janë vendet ku saktësisht mund të takohet Muhamedi në ditën e kijametit?

Përgjigje: Enesi r.a. ka kërkuar prej Muhamedit a.s për më ndërmjetësuar për të në (ditën e kijametit). Muhamedi a.s. i ka thënë: Po unë do të ndërmjetësojë. Pastaj Enesi i ka thënë: Por ku me të kërkuar ty në ditën e kijametit?

Është përgjigjur:Më kërko në rend të parë në sirat (urën e xhehnemit). Po nëse nuk mund të takoj në sirat.

Është përgjigjur: Atëherë do të jem në Mizan (peshojë). Po nëse nuk të gjej te Mizani.

Është përgjigjur:Unë jam te bahçja e ime. Në ditën e kijametit nuk do të jem në ndonjë vend tjetër përpos këtyre tre vendeve.

AHMEDI

PSE I DËRGUARI NUK E KA KOMENTU KUR'ANIN NË TËRËSI

Pse nuk është komentuar Kur'ani në tërësi në kohën e Muhamedit s.a.v.s?

Përgjigje:Kur'ani ka zbritur udhëzim për tërë njerëzimin dhe dritë për mbarë rruzullin tokësor ndërsa Muhamedit s.a.v.s i ka zbrit për 23 vite

Atëherë pse i Dërguari i Allahut nuk e komentuar Kur'anin fisnik në tërësi gjatë gjithë jetës së tij?

E vërteta është se këtu kemi dy grupe:Grupi i parë mendon se komentimi i kohës së Muhamedit s.a.v.s dhe sahabëve është komentim përfundimtar dhe nuk pranon komentim shtesë, bile shtimi në të është një lloj ngarkese (njollose) e Kur'anit fisnik me shumë se atë çka e ka parashtruar dhe e kërkon Libri i Allahut në teorinë tokësore praktike mund të vërtetohet josaktësia e atij komentimi pas disa dekadave

Ndërsa grupi tjetër mendon se Kur'ani ka dy pjesë:Pjesa e parë farzet dhe dispozitat të cilat janë të qarta ,dhe nuk ka dyshim në ato,dhe komentimi i cili është bë në kohën e Peygamberit s.a.v.s i cili është obligativ deri në ditën e kjametit. Ndërsa mrekullitë tjera të Kur'anit ia shtojnë njeriut të kuptuarit. Çdo herë kur shkenca ecë përpara Allahu zbulon fakte në tokë. Nga këtu ,pjesa e Kur'anit e këtij drejtimi është pjesë vazhduese dhe nuk përfundon asnjëherë. U ka dhënë

gjeneratave para nesh ,dhe do tu jep gjeneratave të cilat do të vijnë pas nesh. Pra Kur'ani është burim i pashtershëm i fakteve deri në ditën e kijametit. Anët e mrekullisë së Kur'anit në çdo kohë dhe në çdo vend janë prezentë dhe në ditët e ardhshme do të bëhet zbulimi i disa ajeteve të cilat ne nuk kemi mundur ti kuptojmë plotësisht.

Muhamedi s.a.v.s nuk e ka komentuar Kur'anin në tërësi, gjatë jetës së tij sepse atëherë do të kishin qenë pasive mrekullitë shkencore të llojllojshme, mirëpo ajetet e dispozitave dhe sheriatit janë shpjeguar për arsye se obligueshmëria duhet me qenë e qartë dhe e sakte.

Pra fusha e gjithëpërfshirjes së Kur'anit është burim i pashtershëm i të rejave të llojllojshme dhe të mrekullueshme. Ai i cili e mohon një tekst të qartë dhe të prerë të Kur'anit është pabesimtar,edhe në çështjet të ajeteve të cilat tregojnë qartë mrekullitë hyjnore të gjithësisë,të mendimit patjetër mendjet duhet të kuptojnë edhe pse secili e kupton në rrugën dhe mënyrën e vet në veçanti ,përfundimi del se nuk guxohet të preket në çështjet e akides, besimit dhe imanit të plotë në Allahun e Lartmadhëruar. Kjo është ana e cila ripërtërihet kohë pas kohe, shekull pas shekulli, gjeneratë pas gjenerate, pra ana e të kuptuarit mendor i Kur'anit.

NAMAZI NË ANIJE

Pyetje:-Si falet namazi në anije,kur njeriun e kaplon frika ose i kanoset rreziku i fundosjes për shkak të stuhisë së fortë të detit ose a falet apo nuk falet?

Përgjigje: Xhafer bin Ebi Talibi r.a. e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s për namazin në anije,ndërsa Muhamedi a.s i ka thënë: „Falu në të duke qëndruar në këmbë vetë nëse i frikësohesh fundosjes"

HAKIMI NË MUSTEDREKUNET E TIJ

AXHËRIMI PAS MUAJIT RAMAZAN

Përpos muajit Ramazan cili prej muajve të vitit është më i vlefshëm për ta agjëruar njeriu?

Një njeri e ka pyetur Muhamedin a.s:

- Përpos muajit ramazan për ta agjëruar cilin muaj më kishe urdhëruar për ta agjëruar. Muhamedi a.s iu është përgjigjur:Nëse ke vendos për ta agjëruar muaj pos ramazanit,agjëro muajin Muharrem, sepse ky është muaji në të cilin Allahu fal një popull dhe po ashtu falë një popull(njeri) tjetër.

E ka regjistruar Ahmedi

NE E KEMI KRIJU NJERIUN NË VËSHTËRSI

Pyetje:Në jetë dhe në aktivitete të ndryshme ballafaqohemi me vështirësi të natyrave të ndryshme,ndonjëherë ato vështirësi tejkalohe e ndonjëherë jo.

A është kjo natyrshmëri e jetës së njeriut në këtë botë dhe a është krijuar për kryeneçësi?

Përgjigje: Imami i mirënjohur thotë:Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Ne veç e kemi krijuar njeriun në vështirësi.... E kjo do të thotë se njeriu nga natyrshmëria e përbërjes së tij është i ndërlikuar apo me qenë në vështirësi. Ai i cili dëshiron me qenë i qetë është njeri i cili nuk e ka kuptuar fshehtësinë e krijimit të Allahut sepse Allahu i Lartmadhëruar e ka krijuar njeriun me jetuar në vështirësi. Ia ka krijuar aftësinë dhe e ka dalluar me mendje. Fuqinë njësoj si të kafshës ,pra në vete ka pjesë(përbërje) shtazarake e cila zhvillohet me të cilën pikë ligjet e kësaj bote ,e cila manifestohet në trupat e gjallë, me të cilën pikë bashkohen pjesa e madhe më e madhe e krijesave,mirëpo prej të gjithave atyre krijesave e ka dalluar me mendje,pra Zoti i Lartmadhëruar e ka dalluar mbi të gjitha krijesat me mendje. Po pse? A ke pa ndonjë lloj apo gjeneratë të ndonjë kafshe duke thënë:Duhet që jetën tonë ta zhvillojmë. Ta rrisim komoditetin në shkallën më të lartë, ta ndryshojmë ushqimin në përbërje më të mirë,të zbulojmë ilaçe për

sëmundjet tona dhe të mundohemi ti zgjedhim problemet tona vetë. A ke parë ndonjë gjeneratë të kafshëve se ka vepruar kështu? A ke pa ndonjë kafshë që kur i vendoset ushqimi pranë tij, ai të ketë thënë e dua këtë ushqim e nuk e dua këtë, ose duke thënë :Këtë ushqim do ta ruaj për nesër ose një pjesë të ushqimit do ta ruaj për ditët e ardhshme. A ke pa kafshën edhe pse ai ngopet duke ngrënë ai vazhdon të hajë, po edhe nëse i mëshon dhe sado që i mëshon ai vazhdon të hajë, por hane nuk ndalet sepse ai vetëm e plotëson nevojën e tij, e pastaj që ti ketë mjetet në disponim me qarë ushqimin në vendin e tij.

Pas kësaj shohim njeriun kur han dhe ngopet, e pastaj kur i thua: Ky ushqim është i mirë duhet ta shijosh, ose ia sjell një pjatë tjetër me pamje tërheqëse, të përgatitur mirë ai edhe pse është i ngopur hanë. Ndërsa kafsha han sa kërkon nevoja, pra vetëm mbush nevojën. Këtu shohim s njeriun është në hapësirë ku Zoti i Lartmadhëruar i ka dhënë të drejtë zgjedhje, që ai vetë me vendosë ,ndonjëherë ai merr vendim i cili është i dëmshëm për të, ndonjëherë i cili është i dobishëm. Mirëpo mundësia e vendimmarrjes për të ngrënë ose mos me ngrënë pas ngopjes ose me vepruar diç ose mos me vepruar diç nuk është çështje të cilën e kërkon nevoja apo ndjenja por me të drejtën e tij zgjedhëse. pas kësaj shkojmë dhe shikojmë: A e kemi pa kafshën e merr fëmijën e tij deri sa të bëhen të pavarur, e që në momentin kur fëmija e kafshës rritet ajo ndahet prej prindërve dhe përfundon çdo gjë dhe nuk dinë prindërit ku shkon, sepse roli dhe misioni i tyre ka përfunduar. Pra ndjeshmëria dhe e drejta e të zgjedhurit janë shkak i kryeneçësisë së njeriut dhe vështirësive të tij.

QIELLI DHE TOKA QAJNË

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë:

A është kjo fjalë “qajtje” alegori apo qielli dhe toka qajnë realisht?

Shejh Shaëraviu përgjigjet: Qielli dhe toka qajnë. Po, qajnë dhe ky veprim është veprim i ndjenjave. Qajtja është operacion ,veprim reflektim dhe dalja jashtë për shkak të ndjenjave për diçka. Ti qan për arsye se ke ndonjë ndjenjë për diçka.

“Dëshiron ta sqaroj dhe të vërtetoj pse në të ka ndjenja. Pasi që qielli dhe toka kanë ndjenja mbesin çështje prej të cilave mund të përfitohet e ato janë sende të ngurta, bimët, gjallesat ,për këtë arsye nuk ka ndonjë pengesë për të mos besuar se ata kanë ndjenja, atëherë vetvetiu kuptohet se ata gëzohen për gjërat për të cilat shpërblehen. Pse meritojnë të shpërblehen?

Sepse ato e dinë kuartë se nuk meritojnë shpërblim derisa mbi ta nuk praktikohet programi i Allahut ashtu siq e kërkon Ai.

Pra qielli është gëzuar atëherë kur praktikohet programi i Allahut ashtu siq dëshiron Allahu, por pa dëshirën e saj të drejtpërdrejtë. Pra ai (qielli) është vëlla në fe për te (tokën) dhe kur të jetë e begatuar e ndien veten të kënaqur dhe të gëzuar se është begati edhe për të. Për këtë arsye kënaqësia në jetë varet prej kënaqësisë konkrete dhe abstrakte, pra këtu është konkrete.

„Dhe atij të cilit i peshojnë veprat e mira në vagë ai do të jetoj jetë të kënaqshme”

SI PAGUHEN KOPRRACËT NË KËTË BOTË

Koprracët nuk e pastrojnë pasurinën e tyre me sadaka .Zakonisht ,ata janë të padobishëm, po ashtu janë larg vetes së tyre, larg Zotit të tyre ,larg njerëzve, si është pagesa e tyre në këtë botë?

Përgjigje: Fisniku (bujari) është i afërt të Allahu, i afërt me veten e tij, i afërt me njerëzit. Filozofia e jetës së koprracëve është interesante. Ato në raste të veçanta e japin tërë atë që e fitojnë). Llogaria e tyre është pengimi i asaj që dëshirojnë në jetën e tyre. Ata në jetën e tyre gjithmonë kanë pengesa dhe vazhdimisht në ndalesa.

Fshati i mallkuar koprrac te i cili ka shkuar robi i mirë - Hidri me Musa a.s. të cilët kanë qenë të uritur kanë kërkuar ushqim por banorët e fshatit kanë refuzuar.

Kur Musa.a.s. me Hidrin e kanë rindërtuar murin i cili ishte në rrëzim e sipër,i cili ishte rrezik për banorët nuk kanë kërkuar shpërblim prej tyre. Musa a.s. është habit nga rob i mirë(Hidri) .Si dhe me rindërtuar murin dhe mos me kërkuar shpërblim prej banorëve koprrac të fshatit të mallkuar,të cilët edhe kishin refuzuar me i dhënë ushqim.

„Iu kanë refuzuar me iu dhënë ushqim"

Vet puna e tregon se ai fshat i mallkuar ka qen lajkatar. Pse sikur të rrëzohej muri,apo po të rrëzohej muri ata do të merrnin pasurinë e jetimëve dhe to të kishin thënë: E po të kishin qenë fisnik banorët do të kishin marrë përsipër me e siguruar dhe me e ruajt atë thesar.

Ajo për çka Musa a.s. ka punuar në rindërtimin e murit është e kundërta e asaj për atë çka ka punuar rob i ndershëm (Hidri).Pra e njëjtë qëllime të ndryshme

Sa i përket murit ka qenë i dy fëmijëve jetim të fshatit dhe thesari i tyre ka qen i fshehur nën te. Baba (i jetimëve) ka qenë njeri i mirë. E për këtë arsye Zoti i yt ka dëshiruar që ato të rriten e të forcohen dhe pastaj ta marrin thesarin e tyre prej aty. "Kjo është mëshirë prej Zotit tënd"

EL -KEHF

Pra pagesa e koprracëve është pengimi dhe ndalimi i të mirës për ta

ISLAMI DHE FEMRA

Pyetje: A e ka përcaktuar sheriati llojin e punë në shoqëri ,dhe cilat detyra ia lejon islami femrës për të punuar?

Përgjigje:Duhet të dimë se nëse bëhet unifikimi i detyrave dhe roli i të dy gjinive ,atëherë nuk kishte pasur nevojë për gjini fare: pra për gjininë mashkullore dhe gjininë femërore të sjellim një shembull të shenjave të gjinisë të gjithësisë së kohës. Koha është hapësira e ndodhive. Ndodhitë ndahen në ndodhi të natës dhe të ditës. Koha është si gjinia. Hapësira e ndodhive si të llojit. Pra dita ka rolin e saj , nata ka rolin e saj. Nëse dëshiron të thuash: A janë të njëjta roli i ditës me të natës ose roli i natës me të ditës,atëherë veç ke shkatërruar sistemin natyror të gjithësisë. Sepse nata është krijuar më kryer detyrën e saj,kurse dita të tij..Nëse shohim se një lloj është nda në dy gjini specifikat e përbashkëta të llojit, e pastaj ndaje specifikat e secilës gjini. Allahu kur ka dëshiruar të na sqaroj këtë çështje ka thënë: Shikoni llojet e gjithësisë të cilat janë të pandryshuara e prej tyre është: p.sh. nëse i pyesim biologët thonë:Drita e diellit e kryen rolin e saj për bimët po ashtu edhe nata e kryen rolin e saj për bimët. Bimët lëshojnë dyoksidin e karbonit i cili është i nevojshëm për natyrën,pra nata ka rolin e të ekzistuarit për gjallesat po ashtu edhe dita ka rolin e të ekzistuarit e gjallesave. Nëse ti thua: Po këto janë dy të kundërta ne të kundërpërgjigjemi:Jo, nuk janë të kundërta por kompletues dhe plotësues të njëra tjetrës. Zoti na ka sjell shembull kur ka thënë:„Thuaj(O Muhamed) pa shikoni(e analizoni)po të kishte bërë Allahu natë për ju deri në ditën e kijametit (pra jeta jonë në terr në tërësi)kush pos Allahut do të sillte dritën. A nuk po dëgjoni". Pastaj në ajeti tjetër thotë: "Thuaj:A nuk po shikoni(analizoni)po ta kishte bërë Allahu ditë për ju deri në ditën e kijametit, kush pos Allahut do t'ju sillte natën për të pushuar në të. A nuk po shihni?"Pra secila prej tyre ka rolin e vet,nuk duhet që një lloj ta ngarkoj me detyrën e tjetrit,sepse atëherë do të humbte baraspeshë, ekuilibri dhe do të ndodhte disporporcion. Allahu i Lartmadhëruar na ka sqaruar se çështje primare në ekzistencën është jetesa në te, pra jeta e njerëzve, e pastaj ka tregu çështjen e mashkullit dhe të femrës. Parashtrohet pyetja Si? Ata (mashkulli dhe femra) jan si nata me ditën,ata jan të një lloji,pra llojit njeri,mirëpo të ndarë në dysh:mashkull dhe femër. Atëherë ata dy si qenje njerëzore kanë specifika të përbashkëta në të cilat nuk ndeshën ,mirëpo ata dy si dy gjini prej tyre ka rolin e vet. Lexo fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:Pasha natën kur ajo errësohet(dhe lëshon pëlhurën e saj)dha pasha ditën kur qartësohet(dhe shpalos veten e saj) dhe pasha atë që ka krijuar meshkuj dhe femra,nuk ka dyshim se angazhimijuaj është i shumëllojtë,pra secili prej tyre ka rolin e vet në ekzistencë. Nëse mundohesh që rolin e mashkullit t'ia ngarkosh femrës ose rolin e femrës mashkullit, atëherë, ti ke shkaktuar tronditje

në ekzistencë,sepse sipas kësaj nuk ka qenë nevoja me qenë dy gjinitë dhe specifikat e përbashkëta të tyre. Zoti ynë ka thënë:Mashkulli dhe femra janë të një lloji,prej një brumi ,dhe prej atij brumi ka bërë bashkëshorten e tij,e nuk është ashtu si kanë thënë ideologjitë dhe fetë tjera se shejtani ka krijuar femrën ose Zoti i të keqes e ka krijuar femrën e Zoti i së mirës ka krijuar mashkullin. JO! Islami thotë:Që të dy janë në një përgjegjësi si njeri. Femra është përgjegjëse për punën e saj e mashkulli është përgjegjës për punën e tij. Këtë e sqaron Muhamedi s.a.v.s kur thotë: Burri është ai i cili kujdeset dhe ai është përgjegjës për kujdestarinë e tij, femra është kujdestare dhe ajo është përgjegjëse për kujdestarinë e saj. Përgjegjësia para Allahut “Kush vepron punë të mira qoftë mashkull qoftë femër dhe ai është besimtar. Ne gjithashtu kemi thënë:Femra ka liri në besim ,beson çka dëshiron,mirëpo që nga momenti kur të beson ajo patjetër duhet ti përmbahet atij besimi dhe ligjeve që rezultojnë prej tij. Ajo ka të drejtë të hyjë në besim ,ose mos të hyjë në besim varësisht prej burrit ose prindit të saj. Zoti na ka sjell shembullin e gruas së Nuhit dhe gruas së Lutit. Nuhi dhe Luti që të dy kanë qenë të dërguar,mirëpo përkundër kësaj bashkëshortet e tyre nuk e kanë pranuar fenën e tyre. Allahu sjell shembull për pabesimtarët, gruan e Nuhut dhe të Lutit që të dyja qenë nën kurorë ë dy robërve tanë të mirë, mirëpo ato tradhtuan ata dy dhe kjo te Allahu nuk pat kurrfarë dobie për ato (dy gra) por u tha: Hyni në zjarr me hyrësit tjerë. Pastaj sjell shembullin për besim, Allahu sjell shembullin për besimtarët gruan e firaunit i cili i ka thënë vetes Zot,mirëpo përkundër kësaj asnjëherë nuk ka arrit me bind me hy në fenë e tij.në besimin se ai është Zoti i Lartmadhëruar thotë: Kur tha: O Zoti im më ndërto mua një shtëpi te Ti në xehnet dhe më shpëto nga firauni dhe puna e tij,dhe më shpëto nga populli kriminel. Pra femra ka liri besimi, Islami i ka dhënë femrës të drejtat qytetare të plota të cilat nuk ia ka dhënë asnjë fe tjetër. Femra jehude para martesës ka qenë pronë e babës së saj, dhe nuk ka mund të veproj asgjë në vete,e pas martesës është bërë pronare e burrit të saj. Më vonë ligjet laike si ligji francez XVIII neni 207 thotë: Edhe pse ferma është kushtëzuar që ajo të ketë të drejtë pasurie pavarësisht prej burrit të saj ky kusht shfuqizohet, dhe ajo nuk ka të drejtë të posedimit të pasurisë në mënyrë të pavarur.

Nëse bëjmë një analizë do të shohim se perëndimi është duke ia humb femrës cilësitë e saj. Cilat janë cilësitë primare të njeriut?Forma,reputacioni dhe emri. Në Evropë kur të martohet femra quhet Madam i Filanit,që do të thotë se nuk ka të drejtë ta mban mbiemrin e saj ose babës së saj,ose nënës së saj. Kur tradicionalistët kanë ardhur në Egjipt në fillim të zhvillimit bashkëkohor dhe e kanë pa këtë,ata thanë se duhet të harrohet(fshihet) emri i tyre,ato kanë pranuar me ndërruar emrin e baballarëve dhe nënave mirëpo emrin e tyre e kanë vazhduar ta mbajnë. HEJD Shaëraviu e ka marrë emrin e saj HEJD dhe e ka marrë mbiemrin e familjes së burrit të saj. Ali Basha Shaëraviju nuk iu është dhënë e drejtë me e ndërruar mbiemrin e saj. Mirëpo në Evropë dhe Amerikë e ndërron emrin dhe mbiemrin e familjes(emrin) dhe emërtohet me emrin e burrit të saj. Po çfarë e drejte është kjo, po çfarë barazie e femrës, pasi që t’i merret emri i saj. Në Islam gratë e Pejgamberit të cilat kanë qenë femrat më të nderuara ,nuk janë quajt Madam Muhamed bin Abdullah. Nuk janë quajt Zonja Muhamed por janë quajt Ajshe bin Ebu Bekr, Hafsa bin Umer, Zejneb bin Xhash, pra e kanë ruajtur edhe emrin e tyre edhe emrin e baballarëve të tyre ose të familjeve të tyre. Pas gjithë kësaj dëgjohe zëra,,Dëshirojmë të jemi si perëndimi.Perëndimi nuk i ka dhënë liri femrës as në emërtim as në pasuri, por lirinë të cilën e ka fituar femra, ka qenësi shkak i luftërave. Kur meshkujt kanë shkuar ushtarë në luftë, është ndie nevoja për tu zëvendësuar krahu i tyre në punën qytetare,atëherë ia kanë dhënë disa të drejta për të shtuar prodhimi shoqëror nëpërmjet duarve të tyre. P.sh. Sokrati thotë: Femra nuk është e përgatitur për të kuptuar diç në dituri,por nga natyrshmëria e saj ajo është e përgatitur për kuzhinë dhe edukim të fëmijëve. Pas tij vjen Platoni i cili i jep pak të drejtë për dituri ,mirëpo që të gjithë ngriten kundër tij dhe e kundërshtojnë. Kundër tij ngritet edhe Filozofi Aristofani i cili shkruan librin “Gratë MUTEHADHLIKAN dhe i akuzon gratë të cilat kanë arrit shkallë të lartë të diturisë. Pas tij vjen Molier Fransi dhe shkruan “Paramendimi i grave. Mirëpo Islami nuk e ka marrë atë qëndrim por ka thënë: “Kërkimi i diturisë është farz për çdo musliman

e muslimane, pra ne e kemi b  farz arsimimin e femr s. Kur i D rguari i Allahut s.a.v.s  sht  martuar me Hafsa bin Umer r.a., nd rsa para martes s te sht pia e Umerit shkonte nj  grua nga Beni Adij ku e ka m suar shkrim e leximin. I D rguari i Allahut s.a.v.s. ka k rkuar nga Omeri r.a. q  ajo t  vazhdoj  m simin te sht pia e t  D rguarit. Omeri r.a. i thot :po ajo e ka p rfunduar m simin-nd rsa i D rguari i Allahut s.a.v.s. i thot : le ta p rs ris dhe ta p rforcoj . Femra le t  m soj ,por edhe t  m soj at  q  i p rshtatet llojit t  saj. Ne i ndajm  meshkujt nga shkolla fillore n  paralele dhe n  drejtime p.sh. industri, bujq si, tregti etj. P r femra me m suar m simin p rkat s dhe drejtimin i cili i p rshtatet asaj q  ajo me leht si me i arritur pik synimet e saj. Femra duhet t  jet  fal nderuese p r t  mirat q  ia ka dh n  Allahu sepse njer zit punojn  pun  t  llojeve dhe drejtimeve t  ndryshme. Bujku e blegtori angazhohet n  edukimin e kafsh ve,industrialisti punon n  industri nd rsa femra merret me edukimin dhe arsimimin e krijes s m  fisnike,pra me edukimin e njeriut. femra nuk d shiron q  n  k t  mision t  d shtoj  ,femra e cila d shiron ta kryej  detyr n e saj si edukuese e familjes, si grua, si n n  etj etj. nuk i lejon koh  me u marr  me pun  tjera. Le t  m soj  dhe t  jet  m suese speciale,ose le t  m soj  rrobaqep si p r f mij t e saj dhe t  tjer ve. N se shikon aktivitetin e saj n  jet  ajo sjell p rfitime n  sht pi m  shum  se sa paga mujore, na plot son neve nevojat dhe bukurin e saj n  jet n ton . Pastaj shikojm  realitetin. n se femra sa m  shum  q  ngritet m  lart n  pun  a d shiron q  edhe m  shum  t  punoj  apo sa m  shum  q  ngritet me pun , dhe sa m  shum  q  shtyhet n  mosh  d shiron q  t  jet  edukuese e familjes deri sa edhe grat  e per ndimit si Merlin Monro e cila ka th n  Ruajuni nga dritat t  cilat ju verb rojn . Po t  rikthehej jeta ime prej fillimit do t  d shiroja q  t  isha edukuese e familje kur  sht  b  statistika n  mes t  vajzave dhe grave rreth asaj se sa prej tyre kan  d shir  t  q ndrojn  n  sht pit    tyre dhe ta ken  detyr n si edukatore e familjes? Pra  shtja  sht  se n  per ndim ka  ka tek ne nuk ka. Neve nuk duhet t  shikojm  atje e n  baz  t  atjehit me rregulluar jet n ton ,sepse n  per ndim q  nga momenti kur t  rritet familja ,largohet nga familja dhe fillon jet n e pavarur po edhe vajza q  nga momenti kur t  rritet i thuhet ,tani shko ku t  duash. tek ne nuk ka nevoj  q  femra t  ballafaqohet ,me probleme n  shoq ri p r t  siguruar jet n e saj Kur per ndimi e ka shpikur dit lindjen e gruas, ne e kemi pasuar verb risht, dhe nuk i kemi analizuar shkaqet t  cilat kan  ndikuar q  per ndimi t  shpik  nj  dit  t  till , pra dit n e n n s. Intelektual t per ndimor kur kan  v rejt se f mij t kan  harru n nat e tyre dhe nuk p rkujdesen e nuk i kushtojn  r ndesi atyre kan  vendosur q  t  caktojn  nj  dit  n  vit q  f mij t s  paku n  at  dit  ti kujtojn  n nat e tyre,mir po tek ne fest  e n n s  sht   do  ast prej  asteve t  saj n  sht pin  e saj. tek ne q  nga momenti kur njeriu del nga sht pia ia puth  dor n n n s s  saj ,k rkon lutje prej saj,dhe gjithmon  i kthehet me dhurata pra tek ne nuk  sht  e domosdoshme p r nj  fest  t  till . Mir po ne e kemi marr  se  sht  nj  tradit  prej traditave per ndimor nd rsa ajo  sht  nj  tradit  prej traditave per ndimore ,nd rsa ajo  sht  n n mim p r te. Tek ne nuk  sht  k shtu. Islami i ka parapa t  drejtat n  baz  t  aft sive t  prind rve. Islami i ka renditur t  drejtat: (n n n t nde, pastaj n n n t nde, pastaj n n n t nde, pastaj bab n t nd) Sepse babai yt  sht  burr  sa q  edhe n se b het lyp s e ka leht  ,nd rsa n na jo.

Kur'ani n  m nyr  t  ve ant  e thekson k t   shtje kur thot :Dhe ne e kemi porositur njeriun q  t  sillet me prind rit me mir si"Mir  pra po porosit  p r mir si ndaj prind rve,mir po n se i analizon ajetet kur'anore ,shohim se ajetet vazhdimisht pas porosis  p r mir sjellje t  p rbashk t e cek n  m nyr  t  ve ant  n n n,pra vazhdon ajeti,,e ka bart  n na e tij me plot v shtir si dhe e ka lind me v shtir si,e ka bart dhe i ka dh n  gji(q  t  dy operationet s  bashku) tridhjet  muaj. Kjo do t  thot  nuk e ka p rmend zanafill n pre bab s!!!

RRIZKU A DO TË THOTË VETËM PASURI APO KA KUPTIM GJITHËPËRFSHIRËS

Përgjigje: Disa mendojnë se risku ka të bëjë me pasurin dhe mjetet tjera të dobishme në tokë, por ne themi Jo!

Pse? Risku është çdo gjë me të cilën njeriu përfiton dobi ,ushqimi është risk, por edhe çdo lëvizje e aktivitet në jetë është risk. Pra mos thuaj se unë nuk kam risk (furnizim) për të shpërnda. Ti kë shëndet për të cilin jep sadaka duke ndihmuar të paafit..

Ti ke dituri me të cilën e këshillon tjetrin për të mirë.

Ti ke dituri me të cilën e mëson (jep sadaka) të paditurin.

Kur thotë Zoti i Lartmadhëruar : “Dhe me atë çka i kemi furnizuar (rezaknahum) shpërndajnë”.

Ky ajet përfshin të gjitha çështjet e jetës, të gjitha çështjet plotësuese në ekzistencë janë risk(furnizim),sa që nëse ndonjë njeriut i mungon diçka e ti ia plotëson do të thotë i ndihmon pse ti disponon e ai jo-kjo është çështje risk (furnizim).

Pra plotësimi i mungesës së diçkaje është risk.

SI ËSHTË BË TAKIMI I MUHAMEDIT S.A.V.S. MË PEJGAMBERËT TJERË KUR AI KA QENË I GJALLË NDËRSA ATA TË VDEKUR

Pyetje:Si është bë takimi i Muhamedit s.a.v.s me pejgamberët kur ai ka qenë i gjallë ndërsa ata të vdekur?

Imami i mirënjohur përgjigjet:

Kur'ani ka shumë ajete, nëse njeriu ndalet e përqendrohet në të gjitha ato do të përfiton thelbin në të cilin duhet bazuar, pasi që ai noton me imanin e tij nëpër ta dhe nëpërmjet ngjarjeve si p.sh. mënyra si është takuar me pejgamberët, si iu ka falë namazin atyre përderisa ai ka qenë gjallë,sipas ligjit të gjallëve,ndërsa ata të vdekur sipas ligjit të vdekurve. E si bëhet takimi i të gjallit me ligjet e të gjallëve ndërsa i vdekuri me ligjet e të vdekurve,dhe e kanë kryer së bashku një veprim.

Është e vërtetë se njeriu kur ndërlihet me shpirtin e tij ndërlihet në forma të ndryshme. Është i ndërlihur kur është i gjallë, mirëpo në këtë rast ka dy forma të ndërlihdjes, ndërlihet kur ai është në gjumë ,i cili ka ligj në vete,dhe kur ai është zgjuar i cili po ashtu ka ligj në vete. Mirëpo edhe të zgjuarit edhe gjumi jan dy çështje të të gjallëve. Të lëmë anash çështjet sekrete të jetës në varr(Berzahit)dhe pas ringjalljes,pse ne po flasim për çështjet të cilat jan në sferën tonë. Unë po kam dy staturë, statusi i parë gjallë dhe statusi i dytë gjallë në gjumë. Shpirti ka lidhje me trupin kur jemi zgjuar,e ky është ligj i veçantë ,dhe po ashtu shpirti ka lidhje me trupin kur jemi fjetur e po ashtu edhe ky ligj është i veçantë. Nëse e analizojmë ligjin e shpirtit më trupin fjetur ,a është po i njëjti ligj i lidhjes së shpirtit me trupin zgjuar? Natyrisht jo,nuk është një lidhshmëri Jo. Parashtrohet pyetja: Pse? Thuhet se unë e kam në gjumë(ëndërr) filanin i cili kishte veshjen ngjyrë të kuqe, e tjetri veshje ngjyrë gjelbër. Pra unë po shoh ngjyra, ndërsa sytë i kam të mbyllur. Çka është ajo që më ka bë që ti shoh ngjyrat pa mjet(mjetin e syve) pasi që unë jam në gjumë dhe sytë i kam të mbyllur!? Pra, po ekzistuan mjete prej mjeteve të të perceptuarit të cilat nuk i kam(drejtperdrejtë) dhe mjete prej mjeteve shqisorë me të cilat flas e ndiej dhe përjetoj gjërat jo me mjete shqisore të veçanta. Që në momentin kur trupi im bie në gjumë, shpirti fillon të reflektoj dhe të paraqitet me trupin, e i jep kuptim të mrekullueshëm e pas kësaj kohe nuk e ka fuqinë dhe dominimit, por ka ligj tjetër të veçantë. P.sh. sheh deri sa je në ëndërr vëllezërit tu mahnitën me ty,qeshin ,hanë ,pinë, po ashtu e tjetri deri sa është fjetur së bashku me ty në një krevat është me një grup njerëzish të cilët e rrahin,ti nuk ndien çka i ndodh atij, po ashtu edhe ai nuk ndien çka të ndodh ty.,të jenë një botë tjetër, ai në një botë(hapësirë)

tjetër. Nëse dëshiron që ti ta harmonizosh këtë ligj jo në ëndërr asnjëherë nuk mund ta realizosh.

Pra të zgjuarit ka ligj, gjumi ka ligj. Ligji i shpirtit në gjumë është më i lehtë dhe më i fuqishëm se sa ligji i shpirtit zgjuar. Përdërisa kështu është sa jemi në këtë jetë atëherë si do të jetë me këtë materie kur përfundon dhe humbet. Cili ligj vjen në pyetje pas tij.

A është më i rënd apo më i lehtë se ligji i gjumit ,patjetër duhet me qenë më i lehtë se ligji i gjumit; mundet me shqisuar me pa, me u taku, mirëpo kush është ai i cili mund të zhvishet prej materies së tij dhe ta ndaj shpirtin nga trupi për tu taku me ta. Është Ai ,Allahu i cili ka vepruar me të dërguarin e Allahut s.a.v.s. për me qenë ashtu, proces është më i privilegjuar se procesi i gjumit. Ai e ka zhvesh në tërësi prej qenies njerëzore. I ka bërë me pa gjëra të cilat nuk ka mund për ti pa as zgjuar, i ka pa në tërësi prej një procesi të veçantë. Për këtë i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka kaluar nëpër dy faza. Çdo ëndërr që e shihte e përjetonte plotësisht zgjuar, pra që nga momenti kur Muhamedi s.a.v.s. ka dalë prej materies i ka pa ëndrrat të cilat nuk kanë qenë iluzion por realitet .E si ka qenë puna kur Zoti i Lartmadhëruar e ka pa që Muhamedi s.a.v.s me kaluar krejt në një formë tjetër. A sheh apo nuk sheh. Ai ligj a është ligj më i ngritur se ligji i gjumit apo jo? Pasi që ai ka qenë ligj i Berzahit (jetës pas vdekjes). Atëherë po çfarë lidhe ka shpirti me trupin në botën tjetër. Do të jetë sistem i veçantë.

Pra duhet ta dimë se shpirti ka lidhje me trupin kur është zgjuar e pas kësaj prapë shpirti ka lidhje me trupin kur është në gjumë. E ligji i lidhshmërisë në gjumë është më i fuqishëm se ligji i lidhshmërisë zgjuar. Po ashtu shpirti ka lidhje me trupin pas vdekjes në berzah, sikurse do të ketë lidhshmëri me trupin pas ringjalljes kjo lidhshmëri. është superiorja ,dhe përfundimtarja ,për këtë arsye përfundimisht do të jemi krejt diçka tjetër, hamë dhe nuk kryejmë nevojë dhe nuk plakemi, pra botën tjetër duhet ta kuptojmë si lidhshmëri e trupit dhe shpirtit me ligjin e tij të posaçëm. Ligji zgjuar është diçka në vete, ligji në gjumë është diçka në vete, ligji në vdekje është diçka në vete dhe ligji pas ringjalljes është diçka në vete.

NJË E TRETË ,POR EDHE NJË E TRETA ËSHTË SHUME

Cila është shuma maksimale të cilën e ka të drejt njeriu të jep sadaka e në të njëjtën kohë të mos i dëmtojë trashëgimtarët

-Sead ibn Vekasi r.a. e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.:O i Dërguar i Allahut “Siç po e sheh jam sëmurë, ndërsa kam pasuri, mirëpo trashëgimtarë kam vetëm një vajzë. A ta jap sadaka dy të tretën e pasurisë, Muhamedi a.s i ka thënë Jo

-A ta jap sadak gjysmën e pasurisë

-Jo

-Po një të tretën

-Një të tretën po, edhe pse prapë është shumë se ti me lënë trashëgimtarë të pasur është më mirë se sa me i lënë ata duke kërkuar prej njerëzve. Çdo shpenzim të cilin e bënë për të fituar kënaqësinë e Allahut do të shpërblehesh qoftë edhe puthjen që e bën në buzë të bashkëshortes tënde.

A ËSHTË XHENETI I ADEMIT XHENETI I BOTËS TJETËR

Kanë dhënë mendime të ndryshme dijetarët sa i përket xhenetit prej të cilit ka zbrit Ademi a.s. në tokë. A është ai xhenet shpërblim në botën tjetër apo xhenet i kësaj bote, apo bashqë e lulëzuar ashtu si çdo bahçe siq emërtohet xheneti gjuhësisht?

Përgjigje: Xheneti në të cilin ka banuar Ademi a.s nuk është xheneti i shpërblimit në botën tjetër ,sepse në ato xhenete sepse njeriu nuk mund të hyjë në ato xhenet pa marrë shpërblimin për të cilin ka fituar. Dhe xhenetin e shpërblimit për të cilin nuk ka ngarkesë me obligime, dhe aty shejtani nuk mund të hyjë dhe të jetojë. Xheneti në të cilin ka banuar Ademi ka qenë vend i

pasur me të gjitha të mirat e jetës.Allahu ka dëshiruta ushtrojë Ademin dhe bashkëshorten e tij për detyrën e tij apo ngarkimin me obligime të cilën Allahu e ka caktuar me qenë me vullnetin e tij (Ademit a.s.) Vullneti kërkon orientim,e orientimi është urdhër për të mos me vepruar. të gjitha planprogramet e pejgamberëve të cilët i ka dërguar Allahu jan planprograme me ngarkesa të obligimeve,vepro ,mos vepro .Kështu Allahu e ka ushtruar Ademin a.s me detyrën vepro dhe me detyrën mos vepro. Allahu i ka thënë atij dhe bashkëshortes së tij:Hani dhe pini prej saj(xhenetit).Dhe mos iu afroni(mos hani) kësaj peme".Pra simbolika e veprimit „Hani" dhe simbolika e mosveprimit,„Mos hani"(Mos iu afroni).Kështu është parashtruar vullneti më ngrënë atë çka ka lejuar Allahu me ngrënë ,dhe mos me ngrënë prej pemës. Mirëpo kush han pemën,pra i afrohet .Shiko përpikëria praktike.

Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Dhe mos iu afroni" E nuk ka thënë “Mos hani" Sepse të gjitha ndalesat për të cilat Allahu ka kërkuar me u ndaluar. Nuk ka kërkuar Allahu vetëm mosveprim. Por Allahu dëshiron për të na mbrojtur dhe për të na siguruar nga rënia e epshit ton në ato mëkate. Për këtë arsye largohu dhe mos iu afro mëkatit.

LARGIMI NGA FRONTI NË BETEJËN E TEBUKUT

Pse i Dërguari i Allahut ia ka falur gabimin atyre që nuk kanë shkuar në betejën e Tebukut?

Imami i njohur Shaëraviu përgjigjet:

„Të ka falë Allahu ty,për atë pse i ke lejuar ata"

Kur ka përdor Zoti i Lartmadhëruar fjalën “Aff" falje gabimin, do të thotë ka marrë fund. Çdo gjë ,pra të ka falë Allahu ty".Për këtë çështje nuk ka çka të diskutohet,por unë po e tregoj dhe po e them këtë që ta dinë të tjerët të cilët nuk i zbret vaji (inspirimi) atyre,Pra për këtë çështje nuk ka drejtë askush tjetër të merr vendim.

Derisa të kuptohet dhe sqarohen ata të cilët me të vërtetë janë të drejtë,dhe dihet se cilët janë rrenacak. Pra i dërguari e din të vërtetën,dhe vepron me drejtësi,ndërsa të tjerët jo. Kështu problemi ekziston .Ti nuk ke marr vendim, nuk ke lejuar për këtë çështje deri sa ti të kuptosh se cilët kanë folur dhe kanë pasur arsye të vërtet(për mosshkuarje në betejë). Kur ekziston Ai i cili na përmirëson neve dhe atë, nuk ka tjetër i cili ua falë dhe i përmirëson ata(rrenacakët)

UDHËZON CILIN DO ,E HUMB CILIN DO

Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Ai Allahu udhëzon cilin do e humb cilin do. E po ashtu thotë:Allahu udhëzon cilin do në rrugën e drejtë. Pse udhëzimi në rrugë të drejtë nuk është për të gjithë njerëzit?

Imami përgjigjet:Këtu paraqitet pyetja:Kush e përkrah këtë e kush atë e pastaj: A nuk është Allahu, i cili udhëzon cilin do, e humb cilin do" Kur ti sheshojmë ajetet Kur;anore patjetër duhet ti sjellim të gjitha elementet,që do të thotë:Unë i paraqes ajetet të cilat vërtetojnë, dhe ajetet të cilat nuk vërtetojnë atë p.sh.: Allahu i thotë të Dërguarit të Tij s.a.v.s"Mirëpo ne e kemi bërë dritë me të cilën udhëzojmë cilin do prej robërve tanë dhe me të vërtetë Ti udhëzon në rrugë të drejtë. ESH-SSHURA 52. Vërtet Ti ndihmon të udhëzohet. Çka vërteton? Vërtetohet udhëzimi i tij. Ndërsa ajeti tjetër:Vërtet ti nuk mund të udhëzosh atë të cilin ti dëshiron, por Allahu është Ai i cili udhëzon cilin do pse Ai është më i dituri për të udhëzuarit. EL KASAS56. Pra një herë vërteton udhëzimin,herën tjetër e mohon. Dhe është ë pamundur që vërtetimi dhe mohimi me qenë në të njëjtën kohë për udhëzim,por udhëzimi ka dy kuptime:Udhëzim që ka kuptimin e drejtimit dhe udhëzim që ka përkrahjes sa i përket ajetit ku i drejtohet të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. Udhëzimi ka për qëllim orientimin:pra vërtetimi pra vërtet ti orienton në një rrugën e vërtetë".Pra ti i orienton dhe i drejton ata në rrugën e hajrit ndërsa a shkojnë apo nuk shkojnë është krejt çështje tjetër,për të besuar,apo për të mos besuar është krejt çështje tjetër. Ai i cili beson atë që ti e orienton dhe e pranon planprogramin e Allahut dhe dëshmon

vërtetësinë e Allahut. Allahu ia lehtëson atë rrugë dhe e forcon në te. Në ajetin tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Ata të cilët janë të udhëzuar u zgjerohet udhëzimi dhe forcohen në te dhe u shton devotshmërinë” Muhamed17

pra „udhëzimi” ka dy kuptime: E para ka kuptimin e orientimit, apo udhëzimin në punë të mira ose udhëzimin. Që të dy kuptimet kanë një ndërlidhje, „Kuptimi „udhëzim” në punë të mira është ai udhëzimi atij i cili e beson në Allahun dhe e vërteton udhëzimin. Zoti i Lartmadhëruar për të thotë: përdërisa më ke besuar dhe më je bindur dhe e ke pranuar për veten tënde planprogramin tim, Unë do të të përkrahi në këtë program dhe do të mundësoj me shiju ëmbëlsirën e tij. Pra kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: Sa i përket popullit Themud, ne i udhëzuam, mirëpo ata parapëlqyen verbërimin në vend të udhëzimit” Pra ne i drejtuam, i orientuam, por ata dëshiruan humnerën e nuk ranë dakord me tregu rrugën e drejtë. Pra ata kanë thënë: Jo „Ne nuk besojmë se ka Zot, dhe nuk ka për neve rrugë të drejtë. Edhe pse ata nuk besojnë se ka Zot, rruga dhe udhëzimi ekziston, pra ata nuk dëshirojnë të jenë në atë rrugë të drejtë. Është e pamundur që ata të jenë të përqendruar në rrugë të drejtë por mundet me qenë i përqendruar ai i cili beson dhe pranon dhe dëgjon. Kjo i ngjason sikurse më thën: më ke besuar dhe ke pranuar rrugën Time, më ke pranuar për veten tënde, e për këtë arsye unë të ndihmoj në këtë çështje. Kur ta lexosh ajetin jodefinitiv siç është rasti me fjalën e Zotit të Lartmadhëruar “E humb cilin do dhe udhëzon cilin do” patjetër këtë ajet duhet me par ajetin definitiv. ne kemi thënë: na sjell të gjitha ajete Kur'anore të udhëzimit këtu. E humb cilin do dhe udhëzon cilin do” të gjitha janë papërcaktuara (të padefinuara), Ndërsa në ajete tjera Zoti i Lartmadhëruar thotë: Allahu nuk udhëzon popullin pabesimtar” EL BEKARE264

Ata të cilët janë pabesimtarë, e si me i përkrahë në devotshmëri. Kjo s’ mund te ndodh.

Ajeti tjetër: “Allahu nuk udhëzon popullin e mbrapshtë” EL MAIDE100

“Allahu nuk udhëzon popullin e padrejtë-kriminel” EL BEKARE259

“Vërtetë Allahu nuk udhëzon atë i cili është rrenacak e pabesimtar” EZ-ZUMER3

Pra fjala “udhëzim” i Allahut ka kuptimin e lirim të rrugës apo shtimin e rrugës të hajrit, por për cilin? Për atë i cili e beson Atë e pranon atë dhe rrugën e Tij. Pra atëherë ndihma dhe përkrahja vjen prej Allahut. Për këtë arsye: Ai i cili nuk e beson, nuk dëgjon, nuk e pranon rrugën e tij si më përkrah dhe si me i ndihmuar atij? Nuk duhet ti ndihmohet atij. Nëse e sheh në Kur'an një ajet jodefinitiv dhe tjerët definitiv atëherë jodefinitive bartet gjithmonë në definitiv. pra thaj: “Udhëzon cilin do, kjo është e vërtetë, por cilët janë ata të cilët i do Allahu me i udhëzuar. Ata janë të cilët kanë besuar, e kanë pranuar e trasojnë rrugën e tij, ndërsa ai i cili nuk beson Atë e nuk përkrahë dhe nuk e ndihmon rrugën e drejtë, por ndihma dhe përkrahja është për ata të cilët i besojnë dhe e pranojnë me vazhduar dhe me qëndruar në atë rrugë dhe kur ti besohet Atij është i kënaqur në rrugën e Tij atëherë ndihma dhe përkrahja e Allahut është mbi të.

Arsyeja për këtë është që të plotësohet liria e vullnetit sepse për të detyruarin e Allahut nuk ka dënim. Çështja nuk është se kjo është në kundërshtim me logjikën. Ata thanë: Pasi që Allahu e ka shkruar që njeriu me bë gabim atëherë pse me dënuar atë. në kundërpërgjigje: Sepse vazhdon pjesa e dytë : Nëse Allahu e ka shkruar devotshmërinë atëherë pse me e shpërblyer. pyetjen e dytë asnjëherë nuk e kemi dëgjuar. Gjithmonë pyetja bëhet: Pasi që Allahu e ka shkruar me bë gabim pse me e dënuar dhe asnjëherë nuk bëhet pyetja: Pse? Sepse çështja është se ne vetë kemi bë padrejtësi, ndërsa e dyta jo E dëshirojmë që të gjejmë shpëtim dhe rrugëdalje.

KOMENTIMI SHKENCOR NË KUR'AN

Pyetja: Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me komentimin shkencor të Kur'anit?

Përgjigje: Zoti i Lartmadhëruar ka ligjësuar obligime, të cilat ndryshojnë në mendime dhe ide, për të na mbrojtur nga konfliktet e emocioneve dhe epsheve. Ndërsa sa i përket çështjeve, të cilat i nënshtrohet fakteve dhe argumenteve ato janë unikate. Materia është statike, ajo kurrë

nuk e mashtron zbuluesin. Përfundimi ku arrin zbuluesi është ndërhyrja në materie pa epshe dhe emozione të brendshme dhe jashtë dëshirës së tij. Zbuluesi arrin aty u me dëshirën e tij ka depërtuar në materie, por jo sipas dëshirës së tij, por sipas asaj që e kërkon vërtetësia dhe realiteti, sepse materia nuk lejon që zbuluesi të kalojë mbi atë që është faktike dhe argumentuese. Për këta arsye shohim se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka vendosur vija të prera për muslimanët, dhe atë vija të sakta. E ato vija të sakta i ka bërë kandar të këtyre argumenteve shkencore. Pra, cilat janë këto argumente shkencore?

Argumentet shkencore fillojnë prej fakteve të dukshme në gjithësi, pastaj këto fakte nuk vazhdojnë dhe të jenë vetëm çështje të kaluara, por ndalen në pikën e hulumtimit dhe studimit në të, dhe nuk studiohen dhe hulumtohen vetëm për t'u kënaqur dhe për t'u dëfryer, por për të përfutur dhe për të sjellë dobi. Pra, për të marrë atë çështje, atë argument dhe për të ngritur lart jetën. Kur'ani kur të paraqet këtë çështje të gjithësisë thotë:

“Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë, të cilët i shohin, por ata nuk i vështrojnë fare”.

(Jusuf, 105)

Pra, sa argumente në qiell dhe në tokë, Allahu kërkon nga ne që t'i shikojmë në prizmin e studimit, e jo vetëm për t'i kaluar, pra kalimthi, që t'i analizojmë, t'i elaborojmë që nëpërmjet atyre argumenteve të udhëzohemi. Ky është vështrim praktik. Në çështje lëndore dhe praktike kurr nuk ka kundërthënie. E kjo do të thotë se rezultati gjithmonë është i njëjtë. Ne edhe më herët kemi thënë se nuk ka elektricitet sovjeti, e as amerikan. Nuk ka as kimi britanike e as gjermane. Çdo gjë që ka rezultuar prej zbulimeve shkencore ka qenë çështje për të cilën të gjithë janë pajtuar. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka thënë të vërtetën, “Dhe çka ju jep i Dërguari, merreni, e çka ju ndalon, ju largohuni”. *(El-Hashr, 7)*

Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ligjëson diçka ai atë lig e ka sjellë prej Allahut ose tekstualisht ose kuptimor, ose shpjegon ligjin e Allahut. Ndonjëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ligjëson nga vetvetja e tij. Kjo kuptohet nga ajeti Kur'anor: “Dhe çka ju jep i Dërguari, merreni, e çka ju ndalon, ju largohuni”. *(El-Hashr, 7)*

Në lidhje me këtë çështje Shejh Shaëraviju sjell shembull: I Dërguari i Allahut kur shkon te beduinët sheh se ata bënë fekondimin e hurmeve, pra ata vendosnin mashkullorët e hurmeve me femërorët e tyre. I Dërguari i pyet: Po çka jeni duke vepruar? Ata i përgjigjen: Kështu, kështu I Dërguari i Allahut s.a.v.s. u thotë: Mos veproni kështu, sepse edhe pa vepruar kështu do të ketë shumë fryte. Ata e dëgjojnë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe nuk bëjnë fekondimin e hurmeve. Kur vjen sezona e fryteve e shohin se hurmet nuk kanë fryte sikurse vitet e mëhershme. Këtë ia tregojnë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. Ndërsa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka dashur që t'u tregojë në praktikë, duke u thënë atyre: “Ju jeni më të ditur për çështjet e jetës suaj”. Çështjet praktike, faktike dhe argumentuese ju i dini, në ato çështje më nuk ke çka të diskutohet.

Kjo është hapje e mendjes para fshehtësive të kësaj gjithësie që të përfitojmë nga ky shembull, që me aktivitet të sjellim rezultate, por në bazë të rregullit sa më pak angazhim e më shumë rezultat. Islami me këtë dallohet. Islami nuk e dëbon dietarin nga veprimtaria e tij, as ekspertin nga aktiviteti i tij, e as zbuluesin në zbulimin e tij.

Kur'ani nuk cenon asgjë nga kjo apo ajo.

Nëse i bëjmë në vështrim zbulimeve, të cilat zbulime i kanë sjellë dobi kësaj bote do të shohim se ato zbulime janë rezultat i paraqitjes së simptomave apo shenjave në gjithësi (natyrë). Parashtrahet pyetja: Si kemi arritur deri te fuqia e makinës me avull. Kemi arritur ashtu që në rend të parë është pa kjo dukurie. Është pa se është ngritur fuqia mbi masën e paraparë. Kur është hulumtuar dhe është studiuar për shkakun e ngritjes apo rritjes se asaj fuqie është vërtetuar se shkak i shtypjes së avullit e rritë fuqinë dhe ngritë kapakun atëherë është vërtetuar se avulli ka fuqi. Atëherë paska mundësi që të përfitojmë nga ajo fuqi. Pra, çdo zbulim, i cili është arritur është rezultat i paraqitjes së asaj dukurie (zbulimi) në gjithësi (natyrë). Ndërsa Islami dhe shkenca kërkojnë që të sqarohet dhe të vërtetohet dhe të shfrytëzohet që të kemi dobi. E kjo

nuk është në kundërshtim me fenë, por përkundrazi e vërteton dhe e përforcon fenë, sepse, pasi që Islami ka ardhur që program i tij të aplikohet në tërë gjithësinë, atëherë nuk është në dobi të Islamit që t'i lë pabesimtarët që t'i marrin të gjitha fshehtësitë dhe sekretet në ekzistencë, ndërsa ne besimtarët të qëndrojmë larg atyre sekreteve, të cilat sekrete i ka krijuar fuqia dhe madhështia e Allahut.

DRITA E PEJGAMERIT S.A.V.S

-Zoti i Lartmadhëruar thotë: Ju ka ardhur juve prej Allahut drita dhe libri i kuartë. Në këtë ajet fjala dritë ka për qëllim Pejgamberin s.a.v.s apo Kur'anin?

-Pasi që pjesëza “vav” është lidhëse atëherë kjo lidhëse nuk është nënrenditëse, por bashkërenditëse që do të thotë mund të ketë kuptim tjetër prej të parës. Nga kjo mund të kuptohet se fjala dritë nuk ka për qëllim Kur'anin, i cili përmban programin i cili program na nxjerr nga errësira në dritë. Por Muhamedi a.s. është dritë, ai i cili na ka tregu këtë libër (Kur'anin) e kjo na shpie deri te ajo se Muhamedi a.s. është dritë. Muhamedi a.s. para neve ka qenë materie(trup) e njerëzit nuk e kanë pa si materie ndriçuese por si njeri të natyrshëm e të zakonshëm në përbërje fiziologjike

Në shekullin ton, mendja nuk e pranon këtë mendim tonin, është e mundur që materia të jep shkëndija të ndriçuara, dhe çdo shkundi kur takohet dhe kur të bashkohet me shkëndija tjera formojnë materien.

Nga ky rregull nga ky rotacion dhe nga kjo renditje kuptohet çështja e këtij lëmi dhe kësaj shkence. Pse Allahu i ka krijuar çështjet prej drite e kjo dritë do të thotë prej shkëndijave dhe rrezatimeve të dritës së Tij ka krijuar materie.

DUAJA GJAT VIZITËS SË VARREVE

Cila është duaja e cila buron prej thënies së Muhamedit a.s. kur të vizitohen ose kur të kalohet pran varreve.

-Ka dua të shumta për po i përmendim dy:

“Eselamu alejkum shtëpi të besimtarëve, se nuk ka dyshim se me dëshirën e Allahut edhe ne do të jemi tek ju”

“Eselamun alejkum o banorë të varreve të besimtarëve dhe muslimanëve. Zoti na faltë neve dhe juve, ju keni ardhur këtu para nesh e ne do të vijmë këtu pas jush”.

SHTYLLAT E SHKURORËZIMIT

-Cilat janë shtyllat kryesore të shkurorëzimit?

-Shkurorëzimi i ka tri shtylla e ato janë:

E para: Burri ,pra ai është përgjegjës dhe e ka obligim ndaj asaj martese. Nuk lejohet që dikush tjetër pos burrit me shkurorëzuar, se Muhamedi a.s. ka thënë: “Vërtet shkurorëzimin e ka në dorë ai i cili kurorëzimin e ka marrë në dorë.

TRANSMETON IBN MAXHE DHE DARUKUTNI

E dyta: Gruaja me akt të kurorëzimit të plotë pra që është i plotfuqishëm e jo akti i kurorëzimit i cili është zhvleftësuar, ose ka qenë i plotfuqishëm por është bërë shkurorëzimi dhe gruaja në idet as në shkurorëzim me të drejtë kthimi. Nuk pranohet shkurorëzimi i gruas të cilën s'ka çka me shkurorëzuar (pra veç është e shkurorëzuar) e as gruas e cila veç është shkurorëzuar tri herë, ose veç është zhvleftësuese, veç e ka shkurorëzuar pa kontakt me të.

E treta: Formula, fjala e cila tregon shkurorëzim të qartë, ose alegori e cila është e qartë për shkurorëzim. Nijeti për shkurorëzim pa formulë, fjalë e cila tregon nuk mjafton dhe ashtu nuk bëhet shkurorëzim

PSE NJË VARG PEJGAMBERËSH?

Vazhdimisht jan dërguar pejgamber dhe ata gjithmonë jan ballafaquar me vendos të vërtetën dhe me largu të pavërtetën. A nuk ka mjaftuar qe Allahu i Lartmadhëruar me dërguar vetëm një pejgamber dhe vetëm një shpallje me i detyruar njerëzit me dëgjuar atë dhe me i besuar atij.

-Imami i mirënjohur thotë: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë : “Nëse dëshirojmë ne u zbresim atyre prej qiellit një ajet dhe të gjithë do nënshtroheshin përnjëherë”

Por Allahu ka dërguar disa pejgamberë e ata i ka përgatitur me aso fuqie sa që askush ne fytyrën e tokës nuk do të mund ti mposhtë, si p.sh. Sulejmanin a.s.: Ai ka pasur erën, ka pasur ushtrinë e fortë edhe njerëzore edhe xhinore. Ai ka pas fuqi të madhe prej Allahut. Allahu ka pas mundësi më dërguar pejgamber me aso force që njerëzit me i nënshtuar më dëgjuar atë dhe me i besuar atij.

Mirëpo Allahu nuk ka dashur ashtu.

Allahu dëshiron që atë me dëgjuar, atij me i besuar, atij me iu nënshtuar me dëshirë. Kjo është ajo çka dallon njeriun prej gjallesave tjera dhe krijesave tjera. Dëshiron që njeriu më thën:O Zoti im!E kam zgjedh me dëshirë që të jem i nënshtuar tek Ti. E kam zgjedh me dëshirë me të besuar Ty. Jam larguar nga ato që Ti i ke ndaluar vetëm pse Ti më ke lënë të drejt zgjedhje,dhe liri veprimi që pastaj shpërblimi im të jetë i madh tek Ti. Unë të besoj edhe të dëgjoj ,me zgjedhjen e lirë timen.

DUAJA E PAPRANUAR

Të gjithë e dimë se Zoti i Lartmadhëruar ia ka pranuar duanë kur është lutur: Më jep rast dhe leje deri në ditën e ringjalljes".E Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë:„Vërtet ty do të jap rast dhe leje”

Shumica e njerëzve pyesin “Ne bëjmë dua te Allahu gjithmonë ,ditë e natë dhe nuk na pranohet duaja. Cila është arsyeja e mospranimi të duasë?

Përgjigje: Allahu i Lartmadhëruar automatikisht i përgjigjet duasë për të mirën e robit të besimtarëve,ndërsa si na është pranuar ne nuk e dimë,dhe atë askush nuk e di pos Zotit të Lartmadhëruar, për këtë arsyeje nuk është mirë për neve për me gjykuar për të ardhmen.

Ti ndoshta kërkon diçka që për ty do të ishte dëm i madh edhe pse në shikim të parë duket e dobishme. Ndoshta ne kërkojmë pasuri,gjë që ajo pasuri do të na shkatërronte dhe do të na largonte prej Allahut,na bën që të jemi kryelartë dhe kriminel ndërsa atëherë do të ishte humbje e vërtetë, ndërsa Allahu dëshiron me na ruajtur neve ,dhe me na shpërblyer në botën tjetër. Për me na begatuar me të mira të pakufishme e kjo është pranimi dhe mëshira e Zotit të Lartmadhëruar. E ka folur Zoti i Lartmadhëruar kur ka thënë: “Dhe ju ndoshta urreni diçka por ajo është e dobishme”.

Zoti e di e ju nuk e dini “Njerëzit shohin pjesët e jashtme të kësaj bote dhe nuk i shikojnë gjërat e brendshme të saj. Zoti i Lartmadhëruar me diturin e përhershme nëse është e dobishme të përgjigjet menjëherë nëse e sheh të dëmshme e vonon.

ZËVENDËSIMI I BURRIT NË GJUAJTJEN E GURALECAVE

Pyetje: Bashkëshortja ime ka qenë në haxh me mua. Për shkak të turmës së madhe a më lejohet që unë t’i gjuaj për të guralecët?

Përgjigje: Lejohet që t’i gjuash guralecët për bashkëshorten tënde edhe nëse nuk ka turmë të madhe.